

RAPORT

nga Sali Berisha

E VËRTETA E NON GRATA-S TË SALI BERISHËS

Korrupsioni transnacional
i zyrtarve si armë
për të shkatërruar opozitën

- Variant i zgjeruar -

Tiranë, korrik 2023

RAPORT¹

(Variant i zgjeruar)

E VËRTETA E NON – GRATA – S SË SALI BERISHËS

Korrupsionit transnacional i zyrtarve si armë për të shkatërruar opozitën.

Nga Sali Berisha

Ish President, ish kryeministër, kryetar i Partisë Demokratike të Shqipërisë

1. Në këtë shënim shpjegues do të paraqes me prova – fakte, dokumenta zyrtare e publike – korrupsionin politik transnacional të zyrtarëve shqiptarë e të huaj, nga pozita e dëshmitarit, nga ku u përballa me përcaktimin tim *non grata*, nga Departamenti i Shtetit dhe më pas nga Home Office, pa asnjë provë, fakt apo dokument, 8 vite pas largimit tim nga çdo funksion drejtues. I bëj sot publike këto fakte, jo vetëm për të provuar atë që kam thënë që në fillim, se përcaktimi im *non grata* ishte pa bazë dhe produkt i lobimit dhe interesave korruptive të Xhorxh Soros, Edi Ramës dhe diplomatëve dhe zyrtarëve të tjerë të huaj të sponsorizuara prej tyre, por në rradhë të parë, për të denoncuar përdorimin e këtij mekanizmi funksional të korrupsionit trans-nacional nga qeveria e Edi Ramës, e cilësuar si qeveria më e korruptuar në Europë, kundër opozitës shqiptare dhe kundërshtarëve politikë.

2. Ambasadorja e SHBA znj. Yuri Kim ka deklaruar dhjetra here publikisht dhe privatisht se ‘fakte kemi por nuk i themi’. Një mision faktmbledhës i Këshillit të Ambasadorëve Amerikanë, që vizitoi Shqipërinë në Maj të vitit 2023, botoi së fundmi një raport (të cituar më tej në këtë dokument), në të cilin thekson se atyre nuk ju treguan prova në lidhje me korrupsionin e pretenduar të z.Berisha dhe se procesi i dezinjimit të tij nuk reflekton drejtësinë amerikane dhe është ndoshta unik në jurisprudencën amerikane. Deri më sot Departamenti i Shtetit nuk ka paraqitur asnjë provë, fakt apo dokument në të cilat ka bazuar vendimin e tij. Ndaj, këtu më poshtë unë do t’ju njoh me ‘provat’ që ka paraqitur Home Office, si bazë të vendimit të tij.

3. Më 21 korrik 2022, Kryeministri Edi Rama njoftoi në Kuvend se ish-presidenti, ish-kryeministri dhe kryetari i Partisë Demokratike të Shqipërisë, Sali Berisha, ishte shpallur *non grata* nga Qeveria e Britanisë së Madhe². Tre orë pas këtij njoftimi, unë mora një letër konfidenciale nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar, firmosur në emër të Sekretarit të Punëve të Brendshme (Home Secretary

¹ Korrespondencat dhe anekset e referuara më poshtë në këtë raport, që janë pjesë e shkëmbimeve zyrtare me autoritetet britanike, mund të gjenden pranë <https://www.sali-berisha.com/ukdocumentsarchive>

² <https://gazetasi.al/non-grata-edhe-nga-britania-rama-paralajmeron-serish-berishen/>

for the Department of the Interior), por pa emrin e personit që e kishte nënshkruar, në të cilën më njoftonin për vendimin për të më pëjashtuar mua hyrjen në Mbretërinë e Bashkuar, bazuar në lidhjet e mia të pretenduara me krimin e organizuar dhe korrupsionin. (Shtojca 1)

4. Pasi mësova për këtë vendim, unë menjëherë informova publikun përmes një konference për shtyp³, në të cilën e denoncova vendimin si politik, të pabazë, të bazuar në shpifje dhe trillime, që i shërbente interesave të të njëjtit grup që kishte sponsorizuar vendimin e Sekretarit të Shtetit, Anthony Blinken, për të më dezinjuar mua non grata në SHBA, në 19 maj 2021⁴.

5. Unë deklarova në atë kohë se megjithëse një gënjeshtër e përsëritur shpesh, mund të fitojë terren, ajo nuk mund të kthehet kurrë në një të vërtetë. Unë vendosa të kundërshtoj vendimin e Home Office dhe t'u kërkoj atyre përmes një procesi ligjor që të vërtetojnë akuzat ndaj meje me prova konkrete.

6. Dokumentat zyrtare të dorëzuara nga Home Office para panelit, shprehimisht deklarojnë se burimet kryesore të informacionit të tyre, në numër dhe përmbajtje, janë:

a) gënjeshtër të Fondacionit Shoqëria e Hapur⁵ të George Soros, me të cilin kam qenë në armiqësi të përhershme⁶;

b) shpifje të mediave të sponsorizuara nga Soros –BIRN/ Balkan insight/reporter.al, të cilët në Shqipëri veprojnë si një entitet i vetëm, si dhe,

c) akuza të pabaza dhe sulme politike të kundërshtarëve të mi politikë, Edi Rama dhe mediat e sponsorizuara prej tij, Erion Veliaj, Lulzim Basha, si dhe lobimi i tyre korrptiv dhe shtrëmbërimi i fakteve tek ambasadori britanik në Tiranë z. Alastair King-Smith dhe paraardhësi i tij z. Norman Duncan.

7. Dokumentet e dorëzuara nga Home Office tregojnë se akuzat e tyre mbi lidhjet e mia me krimin e organizuar i referohen konkretisht: 1) Fation Dautit, një person të cilin nuk e kam takuar kurrë dhe i cili nuk ka pasur asnjë pozicion formal apo informal në asnjë prej strukturave të PD-së. 2) Damir Fazlic, një shtetas britanik i cili nuk është dënuar asnjëherë për asnjë vepër penale, në Shqipëri apo në Britaninë e Madhe, dhe në dijeninë time as në ndonjë vend tjetër, e që gjatë qeverisjes sime nuk ka kërkuar dhe as ka përfituar para publike, koncesione apo aset publike, e që gjithashtu nuk ka sponsorizuar asnjëherë PD, mua apo ndonjë zyrtar tjetër i PD. 3) Këto shpifje

³ <https://a2news.com/2022/07/22/sali-berisha-shpallet-non-grata-nga-britania-e-madhe/>

⁴ <https://sot.com.al/politike/dash-reagon-per-gazeten-sot-ja-pse-e-shpalle-non-grata-berishen-afere-i442695>

⁵ OPEN Summary of Exclusion decision – Sali Berisha, date 12 korrik 2021, §9.

⁶ Pas dëbimit nga Shqipëria, në vitin 1992, të dy punonjësve të Fondacionit Shoqëria e Hapur, shtetas amerikanë, Fran Nazi dhe Fred Abrahams, për shkak të bashkëpunimit të tyre me rezidentin e Shërbimit Informativ Jugosllav në Tiranë, marrëdhëniet e mia me George Soros mbetën të vështira. Në vitin 2017, për shkak të vendosjes së të gjitha OJQ-ve të sponsorizuara nga Soros nën ombrellën e Partisë Socialiste dhe ndërhyrjes së OSF-së në reformën në drejtësi, me të cilën sistemi i drejtësisë u vendos nën kontrollin e qeverisë Rama, kam kërkuar publikisht që Shqipëria t'a shpallë non-grata spekulatorin multimiliarder George Soros, si dhe i kam bërë thirrje Parlamentit Evropian dhe Kongresit të SHBA që të ndalojnë aktivitetin e tij politik jashtë SHBA-së.

<https://www.balkanweb.com/berisha-shperthen-nga-cadra-e-pd-soros-te-shpallet-non-grata-shba-te-hetoje-monstren-e-korrupsionit/>

kulmojnë me akuzat për lidhjet e mia me bandat e Elbasanit, të cilat unë i kam denoncuar publikisht më shumë se kushdo tjetër në Shqipëri⁷.

8. Mbi akuzat për lidhjet e mia me Fation Dautin, në përgjigjet zyrtare që ka paraqitur më pas, gjatë procedurës së ankimimit, Home Office është detyruar të pranojë shprehimisht disa herë (Aneks D§25, 42) *“se nuk ka qenë në gjendje të provojë mjaftueshëm se Berisha ka lidhje personale me Fation Dautin”*⁸.

8.1. Akuzat për lidhjet e mia me Fation Dautin kanë vetëm një burim: Lulzim Bashën. Në 21 dhjetor 2021, Lulzim Basha deklaroi se “Berisha shoqërohet nga kriminelë, trafikantë që shqelmojnë derën e sallës”, duke iu referuar faktit se një person, që më vonë mësova se quhej Fation Dauti, goditi një derë në godinën e PD-së, në momentet kur unë me Komisionin e Rithemelimit të PD-së do të hynim në sallë për të zhvilluar mbledhjen e këtij komisioni. Ai gjithashtu njoftoi se do të informonte ambasadat e huaja për këtë.

8.2. Po atë ditë, unë denoncova dhunën dhe deklarova para mediave se: (i) Nuk e kam njohur asnjëherë personalisht Fation Dautin dhe nuk kam pasur asnjë lidhje me të. (ii) Sipas informacioneve që mora nga media, ai është dëbuar në vitin 2018 nga Britania e Madhe. (iii) Më njoftuan se ishte një mbështetës i PD-së, i cili kishte mbështetur Lulzim Bashën në protesta dhe fushata elektorale dhe se vinte nga një familje e persekutuar nga regjimi komunist.

8.3. Që atëherë, deklaratat e mia kanë mbetur të pakundërshtuara dhe askush nuk ka mundur të japë prova se unë kam pasur lidhje me Fation Dautin. Megjithatë, ambasadori britanik në Shqipëri e ka përcjellë deklaratën e rreme të Lulzim Bashës tek Home Office si provë e lidhjeve të mia me kriminelët, së bashku me dizinformatat se Dauti kishte poste në strukturat e PD-së.

9. Home Office pretendon se unë kam përdorur pozicionin tim të zgjedhur për të mbrojtur Damir Fazllicin “...kur dolën prova për kriminalitetin e tij”⁹. Home Office citon si burim të këtij informacioni rrjetin BIRN/Balkan Insight të Xhorxh Soros.

9.1. Damir Fazllic, i cili përmendet në vendimin e Home Office, është një shtetas britanik, që nuk ka qenë asnjëherë i akuzuar apo i dënuar në MB. Ndryshe nga deklarata e Home Office, asnjë provë penale nuk ka dalë kundër Fazllicit në Shqipëri gjatë kohës sa unë kam qenë kryeministër dhe në dijeninë time, as edhe sot e kësaj dite.

9.2. Në vitin 2008, Prokurori Publik Shqiptar (PP) hapi një hetim kundër tij për transaksionet e tij private të blerjes së një toke në Porto Romano, vetëm sepse ai kishte transferuar në Shqipëri para nga një llogari offshore, pavarësisht se kjo ishte e ligjshme në Shqipëri. Përkundër faktit që nuk kishte asnjë indikacion për ndonjë shkelje ligjore nga Fazllic, përveç akuzave të ngritura nga PS, nuk u bë asnjë përpjekje për të ndaluar apo ndërhyrë në procesin e prokurorisë. Hetimi i PP-së u

⁷ OPEN Summary of Exclusion decision – Sali Berisha, fq. 4. Annex A, §8.

⁸ Annex D §42: “It is noted that it has not been possible to sufficiently prove that BERISHA has personal connections to DAUTI.”. Shih dhe Aneks D§25 cituar më poshtë.

⁹ Home Office Exclusion Order.

shtri në aktivitetet e Fazliç në Bosnje, Angli dhe Qipro. PP mori informacion nga disa prej këtyre vendeve¹⁰ dhe nuk ka gjetur asnjë parregullsi, e lëre më prova të kriminalitetit.

9.3. Në një moment gjatë këtij hetimi, PP-ja kërkoi verbalisht ndalimin e Fazliçit në aeroportin e Tiranës dhe sjelljen e tij me forcë për t'a marrë në pyetje, pa lëshuar urdhër ligjor me shkrim dhe pa e thirrur Fazliçin asnjëherë më parë. Kjo kërkesë gojore e prokurorit nuk mund të zbatohet nga organet ligjzbatuese pasi ishte në shkelje të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe garancive bazë të Drejtave të Njeriut, të përcaktuara nga legjislacioni shqiptar¹¹. Institucionet e tjera publike dhe unë personalisht e denoncuam këtë veprim të PP-së si shkelje të KPP dhe të drejtave të njeriut. Kjo sipas Home Office, përbën ndërhyrje në hetimin e PP-së, por në fakt, në çdo demokraci, ndalimi i bazuar në një urdhër ligjor është një nga garancitë themelore të të drejtave të njeriut.

9.4. Kur Fazliçit iu dërgua nga prokuroria një thirrje ligjore për të dëshmuar, ai u paraqit menjëherë në prokurori dhe dha dëshminë e tij. Prokuroria ka marrë dëshmi edhe nga një numër i madh personash të tjerë, përfshirë edhe familjarë të mi dhe nuk ka pasur asnjë përpjekje për të penguar këtë hetim. Pas më shumë se një viti, PP vendosi të mbyllë hetimin për mungesë provash.

10. Edhe pretendimi për lidhjet e mia me bandat e Elbasanit¹², është një gënjeshtër e plotë, që i është përcjellë Home Office nëpërmjet lobimit korruptiv të ambasadorit Alastair King Smith dhe paraardhësit të tij.

10.1. Për herë të parë dhe të vetme, kjo akuzë është artikuluar nga Lulzim Basha në nëntor 2021. Ai deklaroi se në Elbasan, Berisha po mbledh firmat e delegatëve të PD-së për të thirrur Kuvendin e PD, me ndihmën e bandës së Elbasanit¹³.

10.2. Unë reagoja menjëherë kundër kësaj gënjeshtre, duke thënë se nuk kam pasur asnjë lidhje me asnjë bandit apo bandë të Elbasanit apo ndonjë bandë tjetër. Gjithashtu informova publikun se më 21 prill 2021, pas vrasjes së doktor Pjerin Xhuvanit në Elbasan, gjatë një përplasje të armatosur me aktivistë të PD-së, Basha më telefonoi dhe më kërkoi që në deklaratën time për mediat në lidhje me ngjarjen, të mos përmendja emrat e bandave të përfshira. Natyrisht që unë e refuzova kërkesën e tij dhe denoncova me emër të gjithë banditët që morën pjesë në ngjarjen tragjike¹⁴. Ndërsa, ish-kryetari i PD-së, Lulzim Basha, për arsye të njohura vetëm nga ai, nuk përmendi asnjë emër në deklaratën e bërë për këtë ngjarje më datë 21 prillit¹⁵.

¹⁰ [Letër-porosit nga Bosnja: Fazliç, asnjë aktivitet të paligjshëm te ne - Arkiva Shqiptare e Lajmeve \(arkivalajmeve.com\)](http://arkivalajmeve.com)

[Prokuroria, subjekt i një historie të gënjeshtërt e të motivuar politikisht për rastin Damir Fazlic - Arkiva Shqiptare e Lajmeve \(arkivalajmeve.com\)](http://arkivalajmeve.com)

<https://www.arkivalajmeve.com/Fazlic-dhe-Remzi-Hoxha-Ina-Rama-niset-drejt-Anglise.110255/>

¹¹ <https://balkaninsight.com/2014/09/23/my-role-in-fazlic-s-extraordinary-interview/>

¹² OPEN Summary of Exclusion decision – Sali Berisha, fq. 4. Annex A, §8.

¹³ <https://dosja.al/basha-akuzon-berishen-kur-do-flet-me-emra-pse-si-denoncon-suel-celen-e-doshin>

¹⁴ <https://dosja.al/sali-berisha-i-plagosur-ne-masakren-e-elbasanit-mbeti-dhe-suel-cela-po-kurohet-ne-nje-spital-privat-me-kelmend-xhaferr-filmimet-i-kontrollon-don-lala>

<https://www.oranews.tv/vendi/nen-kujdesin-e-rames-dhe-balles-denoncimi-i-for-te-berisha-dy-te-fortet--i796839>

¹⁵ <https://dosja.al/basha-vrasja-ne-elbasan-e-rende-te-presim-drejtisine> <https://abcnews.al/lulzim-basha-vrasja-ne-elbasan-e-rende-te-presim-drejtisine/>

10.3. Në lidhje me akuzat për lidhjen time me krimin e organizuar, Home Office është detyruar të pranojë se nuk ka prova konkrete as për këtë akuzë (Aneks D§20), por dëshpërimisht zgjedhë të bëjë deklaratat absurde para të vërtetës që pohon në argumentat e saj. Më saktësisht, në Aneksin D§20¹⁶, Home Office pohon shprehimisht se (i) burimet e Home Office për akuzat që ka ngritur mbi lidhjet e mia me krimin e organizuar vijnë nga raportime të cilat *NUK ofrojnë prova konkrete për këto lidhje*. (ii) se këto raportime nuk pranon t'i bëjë publike¹⁷ dhe se, (iii) pavarësisht se pohon se NUK ka prova konkrete, Home Office zgjedh t'i besojë këto raportime, pasi sipas tij, ato vërtetohen nga rasti i Fation Dautit, për të cilin pak paragrafe më poshtë (§25, 42)¹⁸ pohon shprehimisht se nuk ka mundur të provojë se ka lidhje me mua. (iv) Duke e çuar absurdin në nivel grotesk, pasi ka pohuar një herë se nuk ka prova për lidhje midis Berishës dhe Dautit, dhe më pas se rasti Dauti megjithatë shërben si provë e lidhjes së Berishës me krimin e organizuar, në Aneks D§25, Home Office i heq tullën (provën) e rastit Dauti akuzës që ka ngritur për lidhjet e mia me grupet e organizuar dhe shprehet “*Edhe nese nuk mund të provohet që Berisha kishte lidhje personale me Dautin, kjo nuk e ndikon vlerësimin se ai ka pasur lidhje më të gjera me kriminelë dhe/ose grupe të krimit të organizuar*”¹⁹.

11. Krejt ndryshe nga këto akuza të pabaza, publiku shqiptar e di më së mire se, nëpërmjet fjalimeve të mia publike në parlament, në intervistat e mia në media dhe në Facebook, unë kam denoncuar pa kompromis dhe në mënyrë të vazhdueshme bandat e Tiranës – Shullazin e të tjerë, bandat e Elbasanit, Suel Çelës dhe Çapjatit, bandat e Vlorës – Habilajt, Geron Xhafën, Edison Harizi, Ferdinand Llanaj, bandat e Durrësit – Lul Berisha, Fetajt, Avdulajt, bandat e Shkodrës – Bajrat, e të tjera banda në rrethe të ndryshme të Shqipërisë. Këto denoncime janë pasqyruar gjerësisht jo vetëm nga mediat shqiptare, por edhe nga mediat e huaja²⁰. Një përmbledhje, ndoshta e paplotë, e listës së faqeve të internetit që përmbajnë deklaratat e mia kundër bandave dhe krimi të organizuar është rreth 4 faqe në Microsoft Word. Veç këtyre, vetëm në Facebook-un tim ka qindra postime që denoncojnë kriminelët e bandave të sipërpërmendura.

¹⁶ Annex D §20: “The CSN Project team have assessed that the reporting indicates that BERISHA has been connected to wider criminality, albeit we assess that these indications require (and gain) support from other sources. Whilst these do not provide concrete evidence of such ties, its weight is to be assessed in combination with the video footage of BERISHA with Fation DAUTI (relied on in the original submission of July 2022), as well as the information found at Annex E. The combination of evidence allows for a reasonable degree of confidence in the conclusion that BERISHA has been connected with criminal actors and serious and organised crime. This is therefore another example of BERISHA having benefitted from criminal activity”. See also §23, §24, §25§42.

¹⁷ Aneksi E, që përmendet në §20 nuk është dorëzuar në gjykatë.

¹⁸ Annex D §42: “It is noted that it has not been possible to sufficiently prove that BERISHA has personal connections to DAUTI.”

¹⁹ Annex D§25: “Consequently, even if it cannot be proved that BERISHA had personal connections to DAUTI, this does not impact on the assessment that he has been connected more widely to criminals and/or organised crime groups”. See also §23, §24, §42.

²⁰ <https://gazetasi.al/jehona-belge-e-safet-bajrit-kush-e-mbrojti-ne-shqiperi/>

<http://www.panorama.com.al/denoncimi-kisha-informacion-te-sakte-per-5-kg-kokaine-te-enver-bajrit-por-policia/>

12. Unë i kam denoncuar ato pandalshëm, jo vetëm për të bërë publike lidhjet e pushtetshme që fuqizojnë bandat, të cilat si shpërblim ushqejnë politikën me vota dhe narko – euro, por e kam bërë këtë edhe për të vrarë frikën e qytetarëve dhe gazetarëve ndaj bandave. Ekzaktësisht për shkak të këtij qëndrimi të pakompromis ndaj krimit të organizuar, gjatë gjithë karrierës sime, askush nuk ka artikulluar kurrë ndaj meje akuza për lidhje apo bashkëpunim timin me bandat. Ndaj, akuzat e turpshme të lidhjeve të mia me bandat kriminale janë në të vërtetë një inkurajim për to dhe mbulim i lidhjeve të tyre të vërteta politike.

13. Përveç këtyre, unë kam denoncuar në media, në forume kombëtare dhe ndërkombëtare, miliarderin George Soros, si korruptorin më të madh të politikës shqiptare dhe kam denoncuar plaçet e tij kundër interesave demokratike të popullit shqiptar²¹. Unë kam kritikuar vazhdimisht vendimet korruptive të qeverisë së Edi Ramës për të lejuar kompani naftë të zotëruara nga Soros të ushtronin aktivitet në zona të mbrojtura, duke shkaktuar ndotje ambjentale në kurriz të shëndetit të njerëzve dhe shkatërrimit të ambjentit²². Kujtoj se shpimet për naftë në këto zona janë rreptësisht të ndaluara me ligj²³.

14. Si deputet i opozitës në parlament, unë kam denoncuar publikisht, bazuar në dokumenta dhe prova, lidhjet e kryeministrit dhe dy ministrave të tij të brendshëm e familjarëve të tyre me bosët e drogës dhe krimit të organizuar²⁴. Sipas Departamentit të Shtetit dhe raporteve të tjera ndërkombëtare, këto lidhje e kanë kthyer Shqipërinë në një qendër operationale të krimit të organizuar rajonal, europian dhe botëror²⁵. Shqipëria është kthyer në prodhuesin kryesor të kanabisit në Europë, në rrugën kryesore të hyrjes së heroines në continent, si dhe një nyje kyçe e kokainës nga Amerika e Jugut në rajon²⁶. Shqipëria sot konsiderohet si Kolumbia e Europës ose narko shteti i parë dhe unik i Europës²⁷. Sipas raportit të fundit të OKB, Shqipëria konsiderohet e shtata në botë për prodhimin dhe trafikimin e kanabisit²⁸. Zotërimi i Shqipërisë nga aktivitetet e narko – trafikut është mundësuar nga lidhjet direkte të Edi Ramës me këto grupe. Lidhjet e tij me kartelin e drogës Sinaloa janë bërë publike nga media shqiptare²⁹ si dhe ato ndërkombëtare³⁰. Në dhjetor 2023, gazetari Elton Qyno, I cili kish bërë hetime të thelluara mbi përdorimin e telefonave SKY ECC nga grupet shqiptare të krimit të organizuar³¹, u ndalua për t'u pyetur nga Prokuroria e Posacme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (SPAK). Shtëpia e tij u

²¹ <https://albaniandailynews.com/news/berisha-describes-george-soros-as-architect-of-corruption-in-albania>

²² <https://www.kumtari.al/berisha-kompania-e-naftes-e-lidhur-me-george-soros-shkaterroi-shtepite-e-banoreve-te-patosit/>

²³ <https://55news.al/aktualitet/item/191828-si-rama-e-beri-sorosin-pronar-te-pusit-te-naftes-ne-narte-duke-shkelur-ligjin>

²⁴ <https://abcnews.al/berisha-albania-is-a-center-of-organized-crime/>

²⁵ <https://www.ifimes.org/en/researches/2023-local-elections-in-albania-choice-between-drug-cartels-and-parliamentary-republic/5169>

²⁶ <https://www.ispionline.it/en/publication/albanias-key-position-global-drug-trafficking-31834>

²⁷ <https://www.independent.co.uk/news/world/europe/albania-drug-cannabis-trafficking-hub-europe-adriatic-sea-a8747036.html>

²⁸ <https://lapsi.al/2023/07/03/ne-2021-ne-shqiperi-u-prodhua-3600-ton-kanabis-rekord-nga-2016/>

²⁹ <https://dosja.al/politike/fotot-ekskluzive-rama-prit-ne-zyre-ortaket-e-kartelit-sinaloa-i242770>

³⁰ <https://www.washingtonexaminer.com/opinion/bidens-strange-tolerance-for-albanias-narcostate>

³¹ <https://24-ore.com/elton-qyno-komunikimet-ne-sky-ecc-jane-te-egra-te-etura-per-gjak/>

<https://boldnews.al/2023/10/03/nuk-lokalizoheshin-dot-gazetari-sky-nuk-ka-lidhje-me-valet-e-antenes-por/>

kontrollua dhe iu sekuestruan disa telefona dhe kompjutera. Avokati i z.Qyno deklaroi se këto masa ishin marrë sepse z.Qyno dispononte informacion se këto telefona të enkriptuar ishin përdorur nga zyrtarë të lartë të qeverisë, duke përfshirë kryeministrin Rama, kreun e mëparshëm të policisë Ardi Veliu, zyrtarë të institucioneve të vetingut, si dhe përfaqësues të tjerë të qeverisë³².

15. Korrupsioni i shfrenuar dhe krimi i organizuar janë dhunuesit kryesorë të lirive dhe të drejtave të njeriut, përfshirë dhe të drejtën e qytetarëve shqiptarë për të votuar të lirë. Ato janë arsyeja kryesore për bllokimin e çeljes së negociatave me BE për gjashtë vite. Më keq se kaq, midis 2014 dhe 2021, sipas Eurostatit më shumë se 937.000 shqiptarë, pra një e treta e popullatës, kanë braktisur vendin dhe kanë kërkuar azil në vende të tjera europiane dhe Angli³³. E njëjta gjë ka ndodhur me shumë investitorë të huaj, të cilët janë larguar nga Shqipëria sepse nuk kanë pasur mundësi të ushtrojnë biznesin pa presionin konstant të korrupsionit të shfrenuar dhe krimit të organizuar.

16. Theksoj se gjatë mandatit tim si kryeministër (2005-2013), lufta jonë me zero tolerancë kundër krimit të organizuar e ktheu Shqipërinë në një vend të sigurt, mundësoi anëtarësimin tonë në NATO, nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, liberalizimin e viza me BE-në, marrjen e rekomandimit të Komisionit të BE-së për statusin e vendit kandidat. Në të gjitha këto vendim-marrje, Britania e Madhe ka votuar në favor të Shqipërisë.

17. Lufta e qeverisë shqiptare me tolerancë zero kundër krimit të organizuar në atë kohë mori edhe vlerësime të shumta ndërkombëtare. Një bashkëpunim të veçantë dhe të suksesshëm në luftën kundër krimit të organizuar, përfshi këtu dhe operacionet e fshehta të përbashkëta kundër tij, kemi pasur me organet ligjzbatuese britanike. Duke vlerësuar këtë bashkëpunim, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Krimit të Rëndë dhe të Organizuar (SOCA), Bill Hughes, në shtator 2009 deklaroi në Tiranë se: “Ju jeni një aleat i vlefshëm i Britanisë së Madhe në luftën kundër krimit të organizuar”. dhe se “ne do të kërkojmë që modeli i bashkëpunimit me ju të shtrihet edhe në vende të tjera”³⁴.

18. Burimet që Home Office citon për akuzat ndaj meje për rastet e korrupsionit vijnë së pari nga mashtrime të rrjetit BIRN/Balkan Insight/ Reporter.al, i cili në Shqipëri funksionon si një ent i vetëm, i sponsorizuar nga Soros dhe i shërben agjendës së tij në këtë vend³⁵.

³² <https://www.mcntv.al/2023/12/15/hetimi-p-r-gazetarin-llangozi-do-t-plaste-bomba-e-madhe-p-rmendet-rama-tar-t-vingut-dhe>
<https://www-mcntv-al.translate.goog/2023/12/15/hetimi-p-r-gazetarin-llangozi-do-t-plaste-bomba-e-madhe-p-rmendet-rama-tar-t-vingut-dhe? x tr sl=sq& x tr tl=en& x tr hl=en& x tr pto=wapp>
<https://boldnews.al/2023/12/27/avokati-llangozi-spak-po-fsheh-pergjimet-ku-del-dhe-edi-rama/>
as downloaded on 16 March 2024.

<https://politiko.al/e-tjera/gazetari-amerikan-rama-i-lidhur-me-kartelin-sinaloa-i474934>
<https://ndiqparate.al/?p=18310>

³³ <https://telegraf.al/aktualitet/kane-ikur-700-mije-shqiptare-eurostat-ne-10-vitet-e-fundit-25-e-popullsise-jane-larguar-nga-shqiperia-duke-marre-leje-qendrimi-ne-be/>

³⁴ <http://arkiva.km.gov.al/?fq=brenda&m=news&lid=11482&gj=gj2>

³⁵ <https://www.osfa.al/tematika/media/media-investigative>

Faqja e OSFA: “Gazetaria Investigative vjen si komponent i rëndësishëm i ‘Konceptit të Pandëshkueshmërisë’ të Strategjisë së Fondacionit 2014-2017. Ky komponent ka për objektiv kryesor: Rritjen e raportimit investigativ dhe zhvillimin e kapaciteteve lidhur me të. Në këtë kuadër Fondacioni mbështet BIRN Albania, themeluar në prill të 2014,

19. Një nga akuzat e Home Office bazohet në një titull të këtij rrjeti, i cili përmban vetëm titullin dhe një dokument Microsoft Word, që mund të prodhohej nga kushdo, në lidhje me një marrëveshje bashkëpunimi midis dy kompanive private në fushën e telekomunikacionit, pa asnjë artikull, tekst shpjegues, analizë, dokument autentik, e aq më pak shkrim investigativ³⁶. Dy artikuj të tjerë³⁷ që i referohen Damir Fazlliçit dhe çështjeve të tjera, përmbajnë gënjeshtër flagrante, të dukshme për këdo që i lexon, si dhe trillime të tjera për të cilat rrjeti ka refuzuar të publikojë një përgënjeshtër. Vetë Home Office ka qenë e detyruar të pohojë në një sërë paragrafesh se këto gënjeshtër dhe shtrembërime e dobësojnë burimin e cituar prej tyre³⁸.

20. Përveç këtyre, Home Office ka cituar si prova disa raporte ndërkombëtare që prekin çështjet e korrupsionit në Shqipëri. Bie në sy se Home Office përdor dëshpërimisht si prova raporte që i referohen ekskluzivisht qeverisë së Ramës dhe nuk kanë të bëjnë fare me Berishën dhe qeverinë e tij³⁹. Disa raporte të tjerë, pavarësisht nga titulli i tyre, e ilustrjnë kapjen e shtetit vetëm me shembuj që i përkasin qeverisë së Ramës, ndërsa në lidhje me periudhën e qeverisjes së PD përmendin proceset gjyqësore ndaj tre ministrave të qeverisë. Në fakt, në kontrast të thellë me qeverisjen e PS, gjatë periudhës së qeverisjes së PD, imuniteti i ministrave dhe deputetëve është hequr sa here prokuroria e ka kërkuar një gjë të tillë dhe ministrat i janë nënshtuar procesit gjyqësor. Përveç kësaj ne hoqëm me ligj imunitetin e zyrtarëve për çështjet e korrupsionit⁴⁰. Raportet e Të Drejtave Të Njeriut të Departamentit të Shtetit (2007 – 2010) të cituara, ndërkohë

si pjesë e Rrjetit Ballkanik të Raportimit Investigativ BIRN (www.birn.eu.com), prezent përmes një rrjeti redaktorësh dhe gazetarësh dhe në vënde të tjera të Ballkanit, përfshi Bullgari, Kroaci, Mali i Zi dhe Rumania. Më 1 Prill, BIRN Albania ka nisur një program tre-vjeçar, i cili ka për qëllim të denoncojë korrupsionin dhe pandëshkueshmërinë, nëpërmjet gazetarisë investigative dhe bashkëpunimit të ngushtë midis gazetarëve dhe shoqërisë civile. Programi do të përfshijë: trajnime dhe mentorim të gazetarëve në gazetari investigative; thirrje periodike dhe financim për artikuj që denoncojnë korrupsionin në sektorin publik; monitorim të raportimit të korrupsionit në media; si dhe tryeza të rrumbullakëta për shkëmbim idesh dhe eksperiencash midis shoqërisë civile dhe gazetarëve. Programi ka për qëllim të ekspozojë korrupsionin në shtatë sektorë të ndryshëm, përfshirë Mjedisin, Shëndetësinë, Gjyqësorin, Arsimin, Administratën Publike, Qeverisjen Lokale dhe Krimin e Organizuar Kjo do të arrihet përmes pajisjes së gazetarëve me mjetet e duhura për realizimin e analizave investigative cilësore dhe të pavarura, si dhe duke mundësuar raportim të vazhdueshëm në gjuhën Angleze dhe Shqipe në portalin Balkan Insight (www.balkaninsight.com), dhe në portalin www.reporter.al.

³⁶ [Albanian Telecoms Deal Cost '\\$1m to Buy Off Politicians' | BIRN SOURCE](#) . Annex C§14.

³⁷ [Albania Ex-PM's Daughter Takes Legal Route to Riches | Balkan Insight](#)" <https://balkaninsight.com/2014/07/14/how-berisha-s-inner-circle-profited-from-multi-million-euro-land-deals/>

³⁸ Annex B, §89: "...Our considered view is that though this conflation weakens the article's argument, it still carries weight...". Annex B§90: "Ms Malltezi also contests two points the article makes based on Wikileaks material reporting to be a US diplomatic cable. The original referral case did not place reliance on any of the Wikileaks material referred to in the Balkan Insight article and which purports to be a US diplomatic cable. We continue not to rely on it. The UK Government can neither confirm nor deny the veracity of the Wikileaks material. We do not therefore provide further comment on these points". Annex B§98: "...However, the article does appear to conflate the three law firms, and so wrongly attributes clients of the law firm (...) to the law firm Malltezi (...)". Annex B, §99: "This conflation weakens the strength of the article's argument because these clients cannot be traced back to a law firm directly run by Ms Malltezi"; Annex D §16/d: "...the media outlet is not infallible".

³⁹ Citime të Home Office:

<https://www.scribd.com/document/427073869/HOUSE-OF-LORDS-The-UK-and-the-future-of-the-Western-Balkans-pdf#>

<https://www.state.gov/reports/2019-country-reports-on-human-rights-practices/albania/>

⁴⁰ [2021 Report DeconstructingStateCaptureAlbania English.pdf \(transparencycdn.org\)](#)

që përcjellin problemet e trashëguara dhe të vazhdueshme, tipike për çdo demokraci në zhvillim, theksojnë gjithashtu përpjekjet e dallueshme të Berishës dhe qeverisë së tij, si dhe arritjet e tyre, në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

21. Zgjerimi i parkut të Porto Romanos për të pasuruar biznesmenin Damir Fazliç dhe familjarë të mi. Kjo akuzë qesharake edhe e pabazë buron nga një artikulli i BIRN-it, i sponsorizuar nga Soros, në të cilin pretendohet se qeveria, në vitin 2009, vendosi të zgjerojë parkun ekzistues energjetik të Porto Romanos me 810 hektarë (nga 51 hektarë që ishin miratuar në vitin 2001), për të pasuruar Damir Fazliçin, i cili, gati dy vjet para se të merrej ky vendim, kishte blerë 14 hektarë tokë nga pronarë privatë, prej të cilave dy hektarë nga dhëndri im. Kjo sasi toke ishte pjesërisht brenda parkut ekzistues të miratuar nga qeveria e PS dhe pjesa tjetër në planin e ri të miratuar.

21.1. Akte zyrtare, që mund të kontrollohen nga kushdo, flasin qartë se zgjerimi i parkut energjetik ishte një proces kompleks, që përfshinte disa shtresa vendimmarrjeje nga pushteti vendor dhe qendror, si dhe bashkëpunimin e aktorëve të tjerë. Vendimi u mor pas një studimi të kryer nga ministria përgjegjëse, në përputhje me interesin strategjik ekonomik të Shqipërisë. Vlen të përmendet se aktualisht po shqyrtohet përsëri një zgjerim i mëtejshëm i të njëjtit park.

21.2. Pretendimet se Fazliç e ka blerë këtë tokë bazuar në informacione të brendshme janë gjithashtu të pabaza. Prova publike, me karakter ligjor, tregojnë se potenciali për zgjerimin e parkut ishte fakt i njohur publikisht, që nga koha e qeverisë socialiste (para 2005), si pasojë e publikimit në fletoren zyrtare dhe mediat kombëtare, të disa ligjeve dhe kontratave koncesionare të miratuara gjatë viteve 2001 – 2004 mbi këtë zonë⁴¹.

Theksoj se transaksionet e blerjes dhe shitjes së tokës së Damir Fazlic janë bërë në përputhje të

⁴¹ Transferimi i depositave të naftës nga qeveria e PS-së në vitin 2001, nga porti publik i Durrësit në zonën private të Parkut Energjetik të Porto Romanos, ishte fakt i njohur publikisht, pasi u botua në Fletoren Zyrtare. U deshën pak kohë që toka brenda parkut të shitej dhe investitorët filluan të blinin toka jashtë zonës së miratuar për park. Vendimet e tyre të biznesit nuk u mbështetën në informacione të brendshme, por në informacione ligjore publike, të publikuara në gazetën zyrtare dhe media të tjera kombëtare. Për shembull, një kontratë koncesionare për ndërtimin e një pontili në Porto Romano u miratua në vitin 2004 dhe u kthye në ligj nga Kuvendi i Shqipërisë. Ligji, kontrata e koncesionit, si dhe biznesi i saj, që vinte në dukje interesin e investimit në atë zonë, u botuan në Fletoren Zyrtare (Ligji nr. 9298, datë 28.10.2004, botuar në Fletoren Zyrtare nr.88/2004.) Ligji u ndryshua në vitin 2006 për të përshtatur zgjerimin e objektit, të aktivitetit (për kapacitetet dhe infrastrukturat NLG), gjë që evidentoi dhe publikoi sërish tendencën e vazhdueshme të rritjes së interesit për investime në Porto Romano.

(http://www.energija.al/images/kuadri_ligjor/ligjet/ligj_9578_11_07_2006_portoromano_ndryshime.pdf
Pamja e dokumentit - Qendra e Botimeve Zyrtare (qbz.gov.al)).

Kontrata u pasqyrua gjerësisht në media (<https://tvklan.al/porto-romano-jepet-me-koncesion-20-tetor-2004/>). Për më tepër, për çdo lloj projekti infrastrukturor, legjislacioni shqiptar kërkon që të kryhen konsultime paraprake me komunitetin e interesuar. Ky është një parakusht ligjor i detyrueshëm për miratimin e projektit nga organet vendimmarrëse shumështrësore (lokale dhe qendrore). Shih: Ligjin për ratifikimin e Konventës së Aarhusit për të drejtën e publikut për t'u informuar, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t'iu drejtuar gjykatave për çështje që kanë të bëjnë me mjedisin; ligji nr.8672, datë 26.10.2000, botuar në Fletoren Zyrtare 35/2000. Ligji "Për mbrojtjen e mjedisit", nr. 8934/2002 datë 5.9.2002 kreu X nenet 77-79 Pamja e dokumentit - Qendra e Botimeve Zyrtare (qbz.gov.al) ; Ligji "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", no.8990/2003, date 23.1.2003, neni 20 . Pamja e dokumentit - Qendra e Botimeve Zyrtare (qbz.gov.al) ; Strategjia ministrore për planin e veprimit për zbatimin e Konventës së Aarhusit, Microsoft Word - Strategjia dhe Plani i Veprimit-aarhus.doc (eurokonventa.al) . Akt nënligjor i miratuar nga Ministri i Mjedisit "Për miratimin e metodologjisë për vlerësimin paraprak të ndikimit mjedisor të çdo aktiviteti", nr. 6/2006.

plotë me ligjet shqiptare dhe sipas kushteve të tregut. Ato janë deklaruar, në kohën e nënshkrimit së tyre, pranë të gjitha autoriteteve kontrolluese, përfshi organet tatimore dhe ato të kontrollit të pastrimit të parave. Ky fakt vihet në dukje edhe nga prokuroria, në vendimin e saj për mbylljen e hetimeve ndaj Damir Fazliç.

22. Akuza për pagesë nga një kompani private për kandidatët e zgjedhjeve lokale. Bazuar në një artikull të BIRN⁴², Home Office, përzgjedh interpretime mashtruese mbi faktet, lidhur me disa negociata midis dy kompanive private të telekomunikacionit dhe transaksioneve të tyre private, për investime në tregun e telekomit në Shqipëri në vitin 2006. Më pas i përdor këto interpretime për të sajuar kundër meje akuza që janë gënjeshtër të pastra, se gjoja Fazliç kishte kërkuar 1 milion dollarë për kandidatët e zgjedhjeve lokale⁴³.

22.1. Së pari, në asnjë vend në dokumentin Microsoft Word, të sjellë si provë nga Home Office⁴⁴, nuk specifikohet se cilët kandidatë do të sponsorizoheshin, por aludohet për kandidatë të zgjedhjeve lokale, pa emra konkretë individësh apo partish.

22.2. Për më tepër, Home Office preferon të injorojë deklaratat e vetë burimit të saj, një tjetër artikull i BIRN-it⁴⁵, i cili thotë se “As BIRN dhe as partnerët e biznesit amerikanë nuk kanë qenë në gjendje të konfirmojnë nëse ndonjë shumë parash i është dërguar më pas Partisë Demokratike”. I njëjti artikull pohon se Fazliç thotë se paratë ishin të destinuara për investime biznesi: “(...) nuk më është dhënë asgjë për t’i dhënë Berishës apo Partisë Demokratike”, dhe se ai “... mohon me forcë premtimin se do t’i kanalizojë fonde partisë në shkëmbim për miratimin e marrëveshjes”⁴⁶.

22.3. Duke injoruar qëllimisht prova të njohura publikisht, Home Office thotë se në kohën e transaksioneve të supozuara (2006), Albetelecom ishte një kompani shtetërore, kur është botërisht e njohur dhe lehtësisht e verifikueshme se, qeveria e mëparshme socialiste, në vitin 2004, privatizoi 76% të aksioneve të Albetelecom. Aksioneri privat (Çalik) kishte shumicën e aksioneve dhe kontrollin mbi administrimin e kompanisë. Ai gjithashtu gëzonte të drejtën e parablerjes mbi pjesën tjetër të aksioneve, të drejtë që e ushtroi në procesin e privatizimit të aksioneve të mbetura nga qeveria e PD. Çdo transaksion ndërmjet shoqërisë aksionare private Albetelecom dhe shoqërive të tjera administrohej prej tyre privatisht dhe unë nuk kisha asnjë rol në të. Theksoj se, gjatë viteve të qeverisjes së PD-së, biznesmeni Damir Fazliç nuk ka përfituar asnjë qindarkë nga fondet apo pasuritë publike dhe nuk ka kërkuar apo marrë asnjë tender apo kontratë publike nga qeveria e PD-së. Shtoj gjithashtu se ky biznesmen, që vazhdon biznesin e tij në Shqipëri edhe sot, nuk ka sponsorizuar asnjëherë, direkt apo indirekt, mua apo Partinë Demokratike.

⁴² [Albanian Telecoms Deal Cost '\\$1m to Buy Off Politicians' | BIRN SOURCE](#)

⁴³ OPEN Summary of Exclusion decision – Sali Berisha, Annex 1, §14: “There is evidence to suggest that Berisha benefitted from his connections to Fazlic. For example, minutes from a meeting in 2006 between an American telecoms company and Fazlic regarding a lucrative telecoms contract with the state-owned Albania Telecoms company indicate the US firm was asked to provide a \$1m payment to the Democratic Party.”

⁴⁴ [Albanian Telecoms Deal Cost '\\$1m to Buy Off Politicians' | BIRN SOURCE](#)

⁴⁵ Prova e paraqitur nga Home Office ishte linku, pa artikull, me titullin: [Albanian Telecoms Deal Cost '\\$1m to Buy Off Politicians' | BIRN SOURCE](#). Ne gjetëm në internet një artikull të të njëjtës media që duket se është një zgjerim i titullit të parë. Citimet janë nga <https://balkaninsight.com/2014/10/23/albanian-telecoms-deal-cost-1m-to-buy-off-politicians-claim-us-businessmen/>

⁴⁶ <https://balkaninsight.com/2014/10/23/albanian-telecoms-deal-cost-1m-to-buy-off-politicians-claim-us-businessmen/>

23. Krejtësisht të rreme janë edhe pretendimet, bazuar në artikullin e BIRN-it⁴⁷ të sponsorizuar nga Soros, në lidhje me rastin e një investitori pakistanez, Zafar Ansar, një ish konsull nderi i Shqipërisë në Pakistan, i emëruar nga qeveria Socialiste, i cili në vitin 2008 kërkoi ndihmë nga studioja ligjore e vajzës sime për investimin e tij në një termocentral. Vajza ime ia bëri të qartë z.Ansar, në presence të dy dëshmitarëve të tjerë në takim, se firma e saj do të ofronte shërbime ligjore vetëm për procedura të investimeve direkt strik private, që nuk kishin nevojë për partneritet qeveritar dhe proces tenderimi. Në atë takim ai konfirmoi se ai nuk dëshironte të ndiqte procedura partneriteti me qeverinë, por ato të investimit privat. Më vonë ai ndryshoi mendje dhe kërkoi t'a kanalizonte investimin e tij si PPP dhe kërkoi ndihmën e vajzës sime për të shmangur procesin e tenderimit. Vajza ime e refuzoi këtë kërkesë, në prani të dëshmitarëve, si dhe i shpjegoi atij se tenderimi ishte i detyrueshëm për këtë procedure dhe se nëse ai do të zgjidhte këtë formë investimi, ajo nuk do të mund t'a përfaqsonte më për shkak të konfliktit të interesit. Kur kërkesa e tij për të shmangur tenderimin, një kriter i detyrueshëm për kontratat publike të këtij lloji, u refuzua nga zyrtarët përkatës të qeverisë, z. Ansar, pa asnjë provë apo fakt, shpifi dhe sajoi arsye të tjera për refuzimin e kërkesës së tij. Ai pretendoi, pa paraqitur asnjë fakt apo dokument, se kërkesa e tij ishte rrëzuar sepse ai nuk pranoi të blinte një ngastër toke të ofruar nga studioja ligjore e vajzës sime. Vajza ime i është përgjigjur publikisht këtyre akuzave në kohën kur u bënë. Ajo ka shpjeguar se studio ligjore, nuk dispononte tokë të vetën, ndaj me kërkesë të z.Ansar u angazhuan ekspertë të jashtëm për të lokalizuar parcela toke që përmbushnin kriteret specifike të përcaktuara nga vetë ai⁴⁸. Ndryshe nga sa deklaroi z. Ansar, se atij i ishin dukur tarifat e firmës ligjore të larta, ai në fakt u largua pa paguar një faturë prej 8000 eurosh, për të cilën i detyrohej studios ligjore për tarifat e saj dhe ekspertëve të tjerë të jashtëm, që studio kontrakttoi me kërkesë të tij. Ajo gjithashtu shpjegoi se tarifat e studios së saj përcaktoheshin nga tregu dhe ishin në të njëjtin nivel me ato të studiove të tjera në Tiranë. Dhoma Kombëtare e Avokatisë lëshoi një deklaratë për rastin, duke konfirmuar se tarifat e saj ligjore ishin në përputhje me kuadrin ligjor të Dhomës së Avokatisë⁴⁹. Jurisprudenca e gjykatave shqiptare ka konsoliduar praktikën e njohjes së tarifave të suksesit të avokatëve dhe i ka konsideruar ato pjesë të marrëveshjes private të palëve. Së fundmi, ky qëndrim është konsoliduar me vendim të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë⁵⁰.

⁴⁸ Z. Ansar i kërkoi studios ligjore të kërkonte një parcelë toke të përshtatshme në Porto Romano, që plotësonte kërkesat e tij specifike në lidhje me madhësinë e përafërt të tokës, veçoritë gjeologjike, afërsinë me stacionin hekurudhor dhe linjën e tensionit të lartë. Ekspertë të gjeologjisë, infrastrukturës dhe të pasurive të paluajtshme u angazhuan për të identifikuar zonat e mundshme dhe për të përgatitur një raport, rezultatet e të cilit iu prezantuan z.Ansar. Madje, duke qenë se blerja e tokës së kësaj zone ishte një proces i vështirë dhe i pasigurt për shkak të copëzimit të saj në shumë pronarë, z. Ansar u informua se nuk kishte garanci të plotë mbi mundësinë e blerjes së tokës.

⁴⁹ <https://durrelajm.al/dhoma-e-avokatisë-shperblimi-i-avokatit-shprehje-vullneti-mes-paleve/>

⁵⁰ Gjykata Kushtetuese ka shpallur antikushtetuese një dispozitë ligjore që vendoste një kufi prej 5% për tarifat e suksesit të avokatit. Gjykata e shpalli dispozitën antikushtetuese dhe shkëlqej të parimit të lirisë ekonomike, të parashikuar në nenin 11 të Kushtetutës së Shqipërisë. Shiko Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, vendim no.37, datë 01.12.2022. https://www.gjk.gov.al/web/Lista_e_Vendimeve_92_1.php
https://www.gjk.gov.al/templates/NEModules/kerkese_list/konsulto.php?id_kerkesa_vendimi=3582&language=Ln_g2

24. Duke përdorur shpifjet i njëjti artikull deklaron se vajza ime ka vepruar si portiere për investitorët që vinin në Shqipëri⁵¹. Titulli **bombastik që premtion të tregojë llogaritë bankare dhe veprimtarinë e vajzës sime**, për paturpësinë e autorit, shoqërohet me mashtrime të dukshme, që arrijnë deri aty sa ai paraqet si prova aktivitetin dhe llogaritë individuale bankare të një studioje tjetër ligjore, madje dhe llogari private të personave të tjerë, të cilat pa asnjë prove, i citon si pjesë e pasurisë së vajzës sime. Në disa paragrafë të dokumenteve të saj, Home Office i pranon këto trillime flagrante dhe pranon se ato dobësojnë artikullin⁵². Në fakt, rasti i z. Asnar është ilustrim i fallsitetit të këtyre akuzave. Fakti që atij, pavarësisht lidhjeve me studion e vajzës sime nuk iu pranua kërkesa për të evituar procesin e tenderimit, provon më së miri të kundërtën e asaj që pretendon artikullshkruesi.

25. Një tjetër ilustrim i trillimeve të servitura nga i njëjti artikull i BIRN është **rasti i Pirro Mishës**, një prej kundërshtarëve të mi të njohur, ish-drejtues i Fondacionit Soros në Tiranë, i cili mashtron ambasadorin amerikan duke i thënë se në një konflikt privat midis tij dhe një biznesmeni italian, çështja u zgjidh menjëherë në favor të tij pas ndërmjetësimit ligjor të vajzës sime. Historia, e cila është një gënjeshtër totale, pasi vajzës sime nuk i është kërkuar kurrë të ndërhyjë dhe nuk kishte asnjë ide kush ishin palët, është një shembull i strategjisë së drejtuar nga mediat e sponsorizuara nga Soros dhe përfaqësuesit e tij kundra meje.

26. Këto artikuj u përgënjeshtroan me argumente në momentin e publikimit të tyre përmes një emaili që vajza ime i dërgoi redaktorit të BIRN/ Balkan Insight, por ata nuk pranuan të publikonin përgënjeshttrimin e saj⁵³. Në vitin 2005, gjatë fushatës elektorale unë premtova se do të merrte fund saga e padive gjyqësore të qeverisë kundër gazetarëve dhe se asnjë anëtar i administratës së PD-së, bashkëpunëtorët e mi dhe familja ime nuk do të padisnin gazetarët në gjykatë. Në vend të kësaj, ata do të ishin të detyruar t'u përgjigjen çdo pretendimi publikisht. Në të gjitha rastet, me gjithë partishmërinë e disa gazetave, të gjitha kanë publikuar përgënjeshttrimet e tyre. Rasti i BIRN/ Balkan Insight është i vetmi rast kur media ka refuzuar të publikojë një përgënjeshttrim që hedh poshtë argumentet e artikujve të tyre.

⁵¹ [Albania Ex-PM's Daughter Takes Legal Route to Riches | Balkan Insight](#)

⁵² Annex B, §89: "...Our considered view is that though this conflation weakens the article's argument, it still carries weight...". Annex B§90: "Ms Malltezi also contests two points the article makes based on Wikileaks material reporting to be a US diplomatic cable. The original referral case did not place reliance on any of the Wikileaks material referred to in the Balkan Insight article and which purports to be a US diplomatic cable. We continue not to rely on it. The UK Government can neither confirm nor deny the veracity of the Wikileaks material. We do not therefore provide further comment on these points". Annex B§98: "...However, the article does appear to conflate the three law firms, and so wrongly attributes clients of the law firm (...) to the law firm Malltezi (...)". Annex B, §99: "This conflation weakens the strength of the article's argument because these clients cannot be traced back to a law firm directly run by Ms Malltezi"; Annex D §16/d: "...the media outlet is not infallible".

⁵³ Shih emailin bashkangjitur.

27. E mbetur pa asnjë fakt prove apo dokument për të provuar korrupsionin tim, Home Office me akuzon pa asnjë bazë **për lidhje, nxitje dhe perfitime nga skemat piramidale të 27 viteve më parë.**

Përkundër këtyre akuzave, vetë provat e paraqitura nga Home Office⁵⁴ vërtetojnë drejtpërdrejt dhe pa mëdyshje se piramidat ishin pasojë e moskuptimit të tyre nga qeveria shqiptare, misioni i FMN-së dhe ai i BB-së, si dhe pasojë e mungesës së kuadrit rregullator. Në mungesë të një kuadri rregullator specifik për tregun financiar privat bankar dhe jobankar, skemat piramidale e bazuan veprimtarinë e tyre në Kodin Civil Shqiptar. Eksperti i FMN-së i cituar nga Home Office, shprehet se BB dhe FMN në atë kohë nuk i kanë kuptuar skemat shqiptare piramidale dhe se, **fillimisht kanë sugjeruar që këto skema të integrohen në sistemin formal bankar.** Ata paralajmëruan qeverinë shqiptare për rrezikun e firmave vetëm pak muaj para rënies së tyre⁵⁵.

28. Por ndryshe nga vendet e tjera të rajonit, institucionet publike në Shqipëri nuk patën asnjë përfshirje dhe asnjë investim në skemat piramidale. Home Office nuk ka ofruar asnjë provë për të vërtetuar akuzat e tyre për rolin e tim apo lidhjet e mia me firmat piramidale në vitin 1997, thjesht sepse nuk ka asnjë lidhje të tillë. Unë asnjëherë nuk kam perfituar, nuk kam mbeshetur, nuk kam marrë pjesë në evente apo aktivitete të ndonjë prej kompanive që merreshin me huadhënie dhe asnjëherë nuk kam marrë donacione partiake prej tyre. Faktet tregojnë të kundërtën. Nën udhëzimin tim, u hulumtuan rrugë ligjore për t'i mundësuar qeverisë që të ndërhynte dhe mundësisht t'i mbyllte ato. Kundër njërit prej tyre u ngrit një padi për të vlerësuar nëse kjo rrugë do të ishte rezultative⁵⁶. Hetimi penal i këtyre skemave nga prokuroria nuk zbuloi asnjë lidhje apo

⁵⁴ Home Office u referohet Culture Trip dhe Unheard (Aneksi B, §13, 14, 20, 28, 131), për të cilat deklararon se nuk janë media formale që ofrojnë mbulim të lajmeve. Në fakt e para, është platformë që ofron shkrime për udhëtimet turistike. Shkrimet e saj ofrojnë sygjerime udhëtimesh dhe nuk ofron mbulime apo analiza politike, si dhe nuk pretendon të ketë këtë profil gazetarësh (<https://comms.theculturetrip.com/about/>). Për më tepër, drejtues të rëndësishëm të portlit pranojnë gjenerimin e artikujve nëpërmjet inteligjencës artificiale (<https://medium.com/global-editors-network/culture-trip-a-business-model-combining-media-and-travel-9015dd2fb54>). Gjithashtu ata pranojnë se platforma boton artikuj të sponsorizuar dhe dhe e kanë të pamundur të kontrollojnë përmbajtjen e të gjithë postimeve (<https://www.forbes.com/sites/samshead/2019/07/04/culture-trip-ceo-opens-up-about-bad-reviews-i-cant-say-i-find-it-easy-to-read-that-stuff/#342a7e0e5dbc>). Sa më sipër shpjegon faktin se artikulli i saj nuk ofron asnjë fakt apo detaj, por vlerësime të përgjithshme dhe për pasojë pa asnjë vlerë prove. Artikulli i UnHerd bazohet në intervista të përfaqësuesve të Fondacionit Soros, ministrave socialistë dhe Erion Veliajt dhe reflekton anshmëritë e tyre. Edhe citimet e këtij artikulli përmbajnë vlerësime të përgjithshme, pa emra apo ngjarje, të cilat nuk mund të konsiderohen si prove, pasi asnjë përgjigje nuk mund të jepet për to. Për më tepër, të dy artikujt përmbajnë deklarata të pabazuara, totalisht në kundërshtim me realitetin dhe me faktet, ligjore apo publike, të botuara në media dhe publikisht të njohura. E vetmja reference që mund të debatohet mbi baza llogjike dhe fakte të vërtetueshme është një raport i një eksperti të FMN-së, i cili ka shërbyer në misionin e FMN-së në Shqipëri gjatë periudhës së skemave piramidale. Ky artikull në fakt dëshmon të kundërtën e qëndrimit të Home Office: Finance & Development, March 2000 - The Rise and Fall of Albania's Pyramid Schemes (imf.org). Citimet janë nga variant më i detajuar: IMF Staff Papers - Vol. 47, No. 1, March 2000.

⁵⁵ "The first signs of distress appeared as early as 1996, when the IMF and the World Bank issued a warning to the Albanian government regarding these institutions. Neither the government nor the opposition reacted to this warning." IMF Staff Papers - Vol. 47, No. 1, March 2000, fq. 6-7.

⁵⁶ Vendimi i Gjykatës së Rrethit Tiranë, nr. 3450, datë 30.04.1996. Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. 467, datë 5.2.1997. Gjykata e Rrethit vendosi prishjen e shoqërisë piramidale. Vendimi u ankimua nga kompania dhe çështja ishte në pritje të apelit deri në fund të vitit, kur skemat piramidale kolapsuan. Gjykata e Apelit la në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë në shkurt të vitit 1997.

përfshirje të qeverisë së PD apo Berishës me to. Pas rënies së firmave piramidale, drejtuesit e tyre u arrestuan dhe u proceduan penalisht.

29. Unë dhe qeveria e PD-së pranuan gabimin për moskuptimin dhe lejimin e skemave. Për zgjidhjen e krizës politike në vend ne vendosëm zhvillimin e zgjedhjeve të parakohëshme. Në dallim nga rivali ynë i PS Fatos Nano, i cili premtoi në fushatën elektorale të 1997 se do të kthente çdo qindarkë të humbur nga kreditorët në këto skema, unë deklarova se nuk do të merrnim përsipër borxhin e tyre pasi ky nuk ishte një detyrim i kontraktuar nga qeveria. Pavarësisht se isha i vetëdijshëm se ky vendim do të më kushtonte humbjen e zgjedhjeve, unë zgjodha të zbatoj ligjin. Nëse unë apo qeveria e PD-së do të kishim promovuar, mbështetur apo do të kishim përfshirje në skemat piramidale, ne do të kishim pasur nxitjen për të prodhuar para dhe për të shlyer detyrimet e firmave, gjë që do të shuante dhe rebelimin që pasoi. Por subvencionimi dhe marrja përsipër e borxhit të skemave piramidale do të bëhej në kurriz të qytetarëve që nuk kishin investuar në këto skema dhe do të zhvlerësonte pasurinë e tyre. Ne nuk pranuan t'u vinim këtyre qytetarëve në kurriz një borxh që ata nuk e kishin marrë. Ky qëndrim i autoriteteve shqiptare vlerësohet si qëndrimi i duhur edhe nga vetë eksperti i FMN, i cituar nga Home Office⁵⁷. Në raportin e tij të titulluar “The Rise and Fall of the Pyramid Schemes in Albania”, ai shkruan se, autoritetet shqiptare dhe FMN, fillimisht i konsideruan këto skema si beninjë, me investime reale fitimprurëse dhe kontributorë në rritjen ekonomike të vendit⁵⁸, dhe se për këtë arsye, “...një mision i FMN-së me mision këshillimin për problemet e sektorit financiar, në fund të vitit 1995 u fokusua më së shumti në mundësitë për përmirësimin e sistemit financiar formal duke integruar elementët më pozitivë të tregut informal”⁵⁹. Po aty ai shprehet se autoritetet shqiptare bënë një punë mjaft të mirë në trajtimin e skemave piramidale pasi ato u identifikuan, ku veprimet më të mira ishin refuzimi për të financuar detyrimet e firmave me para të buxhetit, si dhe ngrirja e aseteve në sistemin bankar të dy kompanive me më shumë depozitues⁶⁰.

30. Por gjithashtu, edhe më i rëndësishëm është vlerësimi i Parlamentit të Mbretërisë së Bashkuar, i cili, në një raport të publikuar në vitin 2009, me titull ‘Grabitja më e madhe në histori. Të ndërtohet piramidën e madhe: Shpjegim i krizës globale financiare’⁶¹, flet për kolapsin e skemave të investimeve dhe institucioneve të famshme financiare të Britanisë së Madhe (City dhe të tjerë), duke i krahasuar këto me skemat piramidale shqiptare të vitit 1997, **dhe e vlerëson shprehimisht qëndrimin e qeverisë shqiptare për këtë çështje si qasjen e duhur**. Citoj:

“...Drejtuesit e City, tregtarët dhe financuesit u dëshmuar se ishin furnizues piramidash, jo më të sofistikuar (megjithëse ndoshta me sjellje më të mirë) se sa homologët e tyre gangsterë shqiptarë që kryen skema të ngjashme 1996-97”.

⁵⁷ Faqe 25, 27, *IMF Staff Papers - Vol. 47, No. 1, March 2000*

⁵⁸ The Rise and Fall of the Pyramid Schemes in Albania, fq. 6. *IMF Staff Papers - Vol. 47, No. 1, March 2000*

⁵⁹ Idem, fq. 6-7.

⁶⁰ Idem, fq. 27.

⁶¹ The Largest Heist In History. Building the Great Pyramid: The Global Financial Crisis Explained. Memorandum from Greg Pytel. February 2009. <https://publications.parliament.uk/pa/cm200809/cmselect/cmtreasy/144/144w254.htm>

“Përballë një shkrirjeje të plotë dhe një “skenari shqiptar”, qeveria u pajtua me kërkesat e bankierëve dhe injektoi para në një shkallë të paprecedentë dhe duke dhënë garanci të gjera”.

"Nëse qeveritë ndjekin rrugën e vazhdimit të injektimit të parave, ato do t'i bëjnë taksapaguesit të varur nga sistemi financiar në të njëjtën mënyrë që fajdexhinjtë kriminelë (criminal loan sharks) kontrollojnë klientët e tyre - borxhi i tyre rritet gjithnjë e më shumë dhe klientët vazhdojnë të paguajnë përgjithmonë, për sa më shumë që është e mundur të nxirret prej tyre.”

“Në një ekonomi normale të tregut të lirë, një biznes që dështon duhet të lejohet të shembet. Nëse një biznes është një skemë piramidale gjigante, si sistemi aktual financiar, ai duhet të lejohet të shembet dhe drejtuesit dhe operatorët e tij duhet të ndiqen penalisht. Në fund të fundit, drejtimi i skemave piramidale është i paligjshëm.”

“Nëse qeveritë nuk e likuidojnë skemën piramidale globale, paratë që ato injektuan do të konvertohen me kalimin e kohës në instrumente toksike (p.sh. letra me vlerë) dhe do t'u paguhen organizatorëve dhe klientëve të privilegjuar të këtyre skemave (ose në rastin e Shqipërisë, gangsterëve dhe miqve të tyre klientë).

“Duke parë pas në vitet 1990, gangsterët shqiptarë duhet të ndihen vërtet të inatosur duke pasur parasysht se atyre nuk iu ofrua një paketë e tillë “shpëtimi” fillimisht nga qeveria shqiptare dhe më pas nga Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar”.

31. Theksoj se, në kontrast me këto akuza të pabaza për korrupsion, gjatë viteve të qeverisjes sime, lufta jonë kundër korrupsionit ka qenë një nga prioritetet e qeverisë. Ne krijuam një task force kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, përpjekjet dhe progresi i së cilës theksohen në raportet ndërkombëtare, duke përfshirë Raportet e Departamentit të Shtetit të SHBA (2007 – 2010) të cituar nga Home Office. Çdo kërkesë e paraqitur nga Prokuroria e Përgjithshme për heqjen e imunitetit të ministrave apo deputetëve u pranua pa hezitim nga qeveria ime. Për më tepër, me iniciativën time si Kryeministër në vitin 2012, ne hoqëm me ligj çdo mbrojtje ligjore për rastet e korrupsionit⁶². Këshilli i Evropës vlerësoi se heqja e imunitetit të ligjvënësve në rastet e akuzave për korrupsion ishte ndër rezultatet më të prekshme në luftën kundër korrupsionit⁶³. Për ironi te fatit, ndër ata që kanë vlerësuar më shumë këto arritje është Antony Blinken, gjatë vizitës sime si kryeministër në Shtëpinë e Bardhë, kur ai ka qenë këshilltar për sigurinë kombëtare i zëvendës presidentit Joe Biden⁶⁴.

⁶² <http://arkiva.km.gov.al/?fq=brenda&m=news&lid=6190>

⁶³ <https://www.oranews.tv/korrupsioni-kie-forconi-luften-ndaj-tij-berisha-drejtusia-ne-shqiperi-udhehiqet-nga-biznesi>

⁶⁴ <http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10337&gj=gj1>

<https://a2news.com/2021/05/19/ne-vitin-2009-blinken-vleresonte-kryeministrin-berisha-ne-luften-kunder-korrupsionit-dhe-krimit-te-organizuar/amp/>

<https://opinion.al/ne-vitin-2009-blinken-vleresonte-berishen-per-luften-kunder-korrupsionit/>

<https://dosja.al/dje-e-shpalli-non-grata-si-e-vleresonte-blinken-berishen-per-luften-kunder-korrupsionit-dhe-krimit-te-organizuar-deklarata-e-vitit-2009-qe-ruhet-edhe-sot>

32. Ne ndërmorëm reforma të thella për të luftuar korrupsionin. Hoqëm nga kushtetuta imunitetin e politikanëve për këtë vepër penale, vendosëm *one stop shop* për rregjistrimin e bizneseve, lëshimin e lejeve dhe licencave dhe u bëmë vendi i parë në botë me sistem të plotë dixhital të prokurimeve publike. Vendi ynë plotësoi të gjitha kushtet për të fituar kompasin e Millenium Challenge Corporation. Për të gjitha këto Shqipërisë ju akordua nga OKB çmimi i dytë në botë për transparencën⁶⁵.

33. Suksesi i këtyre reformave bëri të mundur, rritjen e GDP *per capita* dhe, në një *quantum leap* të vërtetë, Shqipëria kaloi nga grupi i vendeve me të ardhura të ulta në grupin e vendeve me të ardhura të mesme – të larta, ndërtimin dhe rindërtimin e mbi 11 mijë km rrugë, dyfishimin e rrogave dhe pensioneve, trefishimin e investimeve të huaja dhe eksporteve.

34. Gjatë viteve në opozitë, kam denoncuar me fakte dhe prova të pakundërshtuara korrupsionin e shfrenuar të kryeministrit Edi Rama dhe ministrave të tij, heshtjen e tij për raportin e OSBE-së të vitit 2014 që pretendonte se ai ka 200 milionë euro të fshehura në llogaritë e tij off-shore, fondet e tij të padeklaruara për ndërtimin e sarajeve të tij dhe pallatit pesëkatësh të gruas së tij⁶⁶, si dhe për qindra tendera të fituara nga familjarët e tij, në shkelje flagrante të ligjit për konfliktin e interesit. Unë e kam dënuar publikisht rritjen me 18 herë të prokurimeve sekrete gjatë viteve të qeverisjes së Ramës⁶⁷, rritjen disproporcionale të çmimit për punët publike, që kur financohen nga paratë e taksapaguesve shqiptarë kushtojnë gjashtë deri në tetë herë më shumë se kur vepra publike realizohet me financimin e Bashkimit Europian në Shqipëri⁶⁸. Unë e kam denoncuar vazhdimisht mungesën e konkurrencës së hapur në qindra tendera, koncesione, PPP, vendime qeverie, si dhe ligje të miratuara nga Kuvendi për t'i shërbyer interesave specifike të klaneve të drogës në Shqipëri⁶⁹. Sipas Bankës Botërore, Shqipëria rradhitet e dyta në botë për rryshfetin⁷⁰. Ndërsa sipas raporteve të Departamentit të Shtetit, korrupsioni në Shqipëri është i shfrenuar dhe i përhapur në të gjithë nivelet e qeverisjes⁷¹.

35. Kohët e fundit, denoncimeve tona në lidhje me aferat e mëdha korruptive të Edi Ramës, përkatësisht PPP për Portin e Durrësit dhe PPP për inceneratorët, u janë bashkuar kritikrat e rënda

⁶⁵ 2010 United Nations Service Award for improving transparency, accountability, and responsiveness in public service. <http://arkiva.km.gov.al/skedaret/Shqiperia-UNAward.pdf>

⁶⁶ <https://www.botasot.info/shqiperia/284788/pd-ankimon-rokaden-e-kreut-te-ildkp-shkarkimi-xhukes-e-votimi-i-ganajt-i-pavlefshem/>

⁶⁷ <http://www.panorama.com.al/tenderet-sekrete-u-ritten-me-18-here-berisha-shteti-eshte-kthyer-ne-nje-makineri-vjedhjeje/>

⁶⁸ <https://boldnews.al/2023/03/18/berisha-80-e-buxhetit-vidhet-nepermjet-puneve-publike/>

⁶⁹ <https://politiko.al/shqiperia-rrezikon-te-behet-nje-narko-shtet-berisha-komenton-analizen-e-medias-italiane/>

⁷⁰ <https://www.topalbaniaradio.com/v7/shqiperia-e-dyta-ne-bote-per-ryshfetin/>

⁷¹ <https://www.state.gov/reports/2021-country-reports-on-human-rights-practices/albania>

të raporteve të aktorëve ndërkombëtarë, si Parlamenti Europian⁷², Departamenti i Shtetit⁷³ dhe Freedom House⁷⁴.

36. Në deklaratën time të datës 21 korrik 2022, theksova se vendimi i Home Office mund të jetë marrë në kuadrin e Five Eyes Treaty, si një detyrim ndaj SHBA. Por ambasadori King Smith me një prononcim në media hodhi poshtë këtë pretendim dhe u shpreh se MB kishte motivet e veta për perjashtimin tim. Në kontrast me këtë qëndrim të ambasadorit, **Home Office pohon se vendimi për perjashtimin e Berishës është marrë për të mbështetur vendimin e Departamentit Amerikan të Shtetit**⁷⁵.

36.1. Më 19 maj 2021, Sekretari i Shtetit Antony Blinken më përcaktoi mua, gruan dhe fëmijët e mi, non grata për shkak të korrupsionit të domethënës⁷⁶, 8 vjet pas dorëheqjes sime nga drejtimi i Partisë Demokratike (PD), pas humbjes së PD-së në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2013, pa asnjë provë, fakt apo dokument, ndërkohë që nuk ka pasur asnjëherë akuza të provuara për korrupsion ndaj meje apo familjarëve të mi. Ky vendim politik erdhi katër javë pasi PD humbi zgjedhjet e përgjithshme, pas të cilave unë kundërshtova prerë një koalicion të mundshëm midis saj dhe Partisë Socialiste në pushtet, duke vlerësuar se kjo gjë që do t'a linte vendin pa opozitë.

36.2. Në një letër të hapur që i drejtova Sekretarit Blinken në të njëjtën ditë⁷⁷, i shkrova se (i) vendimi i tij bazohet fund e krye në dezinformim dhe lobimin korruptiv të George Soros dhe Edi Ramës, (ii) i kërkova të publikonte çdo fakt ose dokument që qeveria e tij ose ndonjë tjetër në planet ka për korrupsionin tim dhe (iii) e sigurova atë se nëse do të kishte një provë të vetme kundër meje, unë do të tërhiqesha menjëherë nga politika. Më 20 maj 2021 informova publikun se, për të mbrojtur dinjitetin tim, kisha zgjedhur sallën e gjyqit dhe ngrita padi për shpifje kundër Sekretarit Blinken në Paris (Tribunal Judiciaire de Paris)⁷⁸.

36.3. Më 21 maj 2021, zëdhënësja e Departamentit të Shtetit, deklaroi për një gazetë shqiptare, se vendimi ndaj Berishës bazohet në shkrime të mediave, raportime të OJQ-ve dhe raportime të qeverisë së Edi Ramës⁷⁹. Vihet re se edhe burimet e referuara nga Home Office janë të njëjtat OJQ dhe media të kontrolluara nga Soros, si dhe raporte të papublikuara të kundërshtarëve të mi politikë.

⁷² https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/A-9-2023-0204_EN.html

https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/A-9-2023-0204_EN.html

⁷³ <https://www.state.gov/reports/2022-country-reports-on-human-rights-practices/albania/>

⁷⁴ <https://freedomhouse.org/country/albania/nations-transit/2023>

⁷⁵ OPEN Summary of Exclusion decision – Sali Berisha, id., pg.1 (iii), pg. 2 (vi), pg. 8§25, OPEN Summary of Exclusion decision – Sali Berisha, Annex 1, §24. Annex B §135

⁷⁶ <https://www.state.gov/public-designation-of-albanian-sali-berisha-due-to-involvement-in-significant-corruption/>

⁷⁷ https://botapress.info/lajmerohet-sali-berisha-i-shkruan-leterpergjigje-sekretarit-amerikan-antony-blinken/?fbclid=IwAR0Zy7iiz4cJeBpCOdsMuw-8zboi11vZ5px_djX6WMN8XpSoKEBmOroMNMQ

⁷⁸ [Former Albanian President to sue US State Secretary Antony Blinken – EURACTIV.com](https://www.euractiv.com/en/former-albanian-president-to-sue-us-state-secretary-antony-blinken/)

⁷⁹ [Former Albanian President to sue US State Secretary Antony Blinken – EURACTIV.com](https://www.euractiv.com/en/former-albanian-president-to-sue-us-state-secretary-antony-blinken/)

⁷⁹ <https://sot.com.al/politike/dash-reagon-per-gazeten-sot-ja-pse-e-shpalleme-non-grata-berishen-aferrat-i442695>

36.4. Që prej 19 maj 2021, Departamenti i Shtetit nuk ka paraqitur asnjë provë, fakt apo dokument për të vërtetuar akuzat e tij kundër meje, pavarësisht kërkesave të përsëritura nga kongresmeni Lee Zeldin dhe nga media⁸⁰. Kongresmeni Lee Zeldin i ka deklaruar Sekretarit Blinken gjatë një dëgjese se vendimi juaj vjen nga hiçi, sepse ne kemi hetuar dhe nuk kemi parë asgjë për korrupsion në lidhje me Sali Berishën, dhe se ju jeni ndikuar nga Xhorxh Soros për këtë vendim. Kongresmeni Lee Zeldin i dërgoi tri letra, në periudha të ndryshme, Sekretarit Blinken dhe nuk mori asnjë dokument apo fakt konkret nga Departamenti i Shtetit⁸¹. Në dhjetra artikuj, mediat amerikane e kanë lidhur këtë vendim me ndërhyrjen e George Soros dhe lidhjet e ngushta familjare të Soros me Sekretarin Blinken⁸²

⁸⁰ <https://m.washingtontimes.com/news/2021/may/28/sali-berisha-ex-albanian-leader-rejects-us-charges/>
<https://www.washingtontimes.com/news/2021/jun/7/antony-blinken-pressed-alleged-george-soros-link-u/>
<https://www.worldtribune.com/secretary-of-state-antony-blinkens-family-ties-to-george-soros-run-root-deep/>
<https://nypost.com/2022/02/06/antony-blinkens-horrific-stain-on-albania-and-its-all-for-george-soros/>
<https://exit.al/en/comment-sanctions-as-a-tool-of-us-foreign-policy-the-use-of-public-designation-under-section-7031-c/>

Former Albanian President to sue US State Secretary Antony Blinken – EURACTIV.com

<https://euronews.al/shpallja-non-grata-e-berishes-philips-nuk-u-zbatuan-parimet-themelore-te-ligjit/>

<https://www.campuslatel.com/the-office-of-the-attorney-general-of-donald-trump-strongly-attacks-us-secretary-of-state-for-george-soros/>

<https://www.washingtontimes.com/news/2021/oct/28/sali-berisha-gets-antony-blinken-defamation-lawsuit/>

<https://bongino.com/former-albanian-president-sues-secretary-of-state-blinken-for-defamation-cites-connections-to-soros/>

<https://bongino.com/secretary-of-state-blinkens-family-ties-to-george-soros-exposed/>

<https://www.eurasiareview.com/16122021-the-misleading-influence-of-foreign-ambassadors-in-albania-oped/>

<https://exit.al/en/comment-the-usas-diplomatic-disaster-in-albania/> <https://www.neweurope.eu/article/amateur-hour-for-us-diplomacy-in-albania/>

<https://freebeacon.com/biden-administration/zeldin-accuses-state-department-of-sanctioning-former-albanian-president-as-retribution-for-loyalty-to-republicans/>

<https://creativestructuremedia.com/video/2022/04/15/io-episode-112-former-albanian-pm-and-opposition-leader-sali-berisha/>

<https://www.neweurope.eu/article/interventionist-us-ambassador-in-tirana-under-pressure/>

<https://bongino.com/former-european-president-exposes-how-soros-infiltrated-his-country>

<https://www.ifimes.org/en/researches/the-role-of-open-society-foundation-in-putting-the-justice-system-under-the-control-of-the-albanian-socialist-party-through-the-judicial-reform/494>

<https://exit.al/en/2022/04/22/appeals-court-remands-pd-leadership-case-as-berisha-and-us-ambassador-trade-accusations-of-interference/>

<https://www.newsmax.com/nikolakedhi/autocracy-berisha-churchill/2022/06/20/id/1075249/>

Donald Lu, George Soros cohort, plays Albania political games - Washington Times

⁸¹ <https://lapsi.al/2021/06/08/non-grata-e-berishes-kongresmeni-leter-dash-kerkoj-nje-shpjegim-te-detajuar-mbi-procesin-e-ndjekur/>

<https://politiko.al/english/e-tjera/berisha-non-grata-kongresmeni-amerikan-i-shkruan-letren-e-trete-dash-it-i448425>

⁸² Idem. See also, Richard Grenell, speech in the Conservative Political Action Conference, July 2021, available at:

<https://www.facebook.com/watch/?v=2926070501045396>

Blinken Acts as Agent of George Soros in the Balkans | American Center for Law and Justice (aclj.org)

36.5. Në fund të korrikut 2021, në vizitën e tij në Tiranë, Asistent Sekretari i Shtetit, Philip Reeker, kërkoi që Berisha të përjashtohet nga parlamenti për shkak të vendimit të Sekretarit Blinken, pa asnjë provë, fakt apo dokument.

36.6. i ngatërruar në atë që do të provohej të ishte një rrjet shantazhi dhe përfitimesh të paligjshme, si dhe nën presionin e fortë të ambasadores së SHBA në Tiranë, Yuri Kim, më 9 shtator 2021, në dhunim të Kushtetutës, rregullave statutoire të PD-së dhe pa asnjë konsultim me strukturat partiake, kryetari i PD Lulzim Basha deklaroi vendimin e tij për largimin tim nga grupi parlamentar. Pas kësaj ai refuzoi të mblidhte forumet e partisë për të votuar vendimin.

36.7. Informacionet që dolën më vonë treguan se, Basha kishte vepruar si peng, i kushtëzuar nga hetimi penal kundër tij në rastin e njohur si financimet ruse. Artikuj të mëparshëm⁸³ kishin aluduar se Basha kish përfituar nga financime ruse, të cilat më pas i kish përdorur për të paguar lobistët në SHBA. Ky informacion më vonë u përforcua nga burime të inteligjencës së huaj dhe raportime të mediave të tjera⁸⁴. Përpjekja e Prokurorisë Publike Shqiptare (PP) për të hetuar burimin e 720,000 eurove, hasi në rezistencë nga ambasadorja amerikane Kim, e cila dyshohet se ka penguar PP-në të marrë dëshminë e një dëshmitari kyç, shtetas amerikan. Megjithatë, PP shtriu hetimet e saj në mundësinë e shkeljes së ligjeve për deklarimin e fondeve nga Basha⁸⁵, shkelje e cila, sipas legjislacionit shqiptar, dënohet me burgim deri në 6 vjet. Pas përfundimit të hetimeve, nën ndikimin e drejtpërdrejtë të Edi Ramës, PP-ja përdori një manovër teknike ligjore për të mos ngritur në kohë aktakuzën ndaj Bashës⁸⁶. Kjo taktikë, megjithatë, nuk e pengon PP-në të rihapë çështjen në të ardhmen, gjë që e ktheu Bashën në një peng të interesit politik të Ramës⁸⁷.

36.8. Për këtë arsye, në përputhje me statutin, ne mblodhëm firmat e 62% të delegatëve të Kuvendit Kombëtar të PD dhe i depozituam ato në PD, një muaj përpara mbledhjes së Kuvendit. Në datë 11 dhjetor 2021, u mblodh Kuvendi i Rithemelimit dhe miratuam ndryshimet statutoire të PD-së. Më datë 18 dhjetor 2021, me referendum të të gjithë anëtarëve të PD-së, Basha u shkarkua nga detyra e kryetarit të PD-së dhe me datë 22 prill 2022, anëtarësia e PD-së, me referendum zgjodhi Sali Berishën kryetar të PD-së.

⁸³ <https://www.motherjones.com/politics/2019/03/prosecutors-question-albanian-politician-on-payments-from-russia-linked-firm-to-gop-lobbyist/>
<https://www.motherjones.com/politics/2019/06/the-head-of-albanias-conservative-party-faces-criminal-charges-and-an-ex-trump-aide-is-involved/>

⁸⁴ <https://www.bbc.com/news/world-us-canada-62897570>
https://www.euractiv.com/section/politics/short_news/albanian-political-parties-spar-over-russian-funding-allegations/

⁸⁵ Zyrtarë të PD deklaruan para PP dhe publikisht se shuma që financat e PD kishin paguar për kontratat e lobimit ishte e vogël dhe se ajo ishte deklaruar pranë autoriteteve kompetente, konform legjislacionit në fuqi.

⁸⁶ <https://5pyetjet.al/2022/09/14/zeri-i-amerikes-si-u-mbyll-dosja-e-bashes-per-parate-ruse/> <https://politiko.al/e-tjera/500-mije-nga-rusia-mother-jones-dosja-e-lulzim-bashes-per-lobim-u-mbyll-i467141>

⁸⁷ See also

<https://www.balkanweb.com/financimet-ruse-ne-pd-berisha-mesazh-bashes-mos-kujto-se-u-mbyll-ky-problem-dodalesh-ketu-para-e-do-deklarosh/>
<https://www.motherjones.com/politics/2023/02/how-the-case-of-arrested-fbi-agent-charles-mcgonigal-is-tied-to-russia-linked-influence-effort/>

36.9. Që nga momenti i përjashtimit tim nga grupi parlamentar i PD-së, ambasadorja e SHBA-së Kim është angazhuar në një fushatë publike të hapur, me deklarata të përjavshme kundër meje dhe ka ndërhyrë në procese gjyqësore kundër PD-së⁸⁸. Ajo ka bërë presion të vazhdueshëm mbi prokurorinë shqiptare që të hapë çështje penale ndaj Sali Berishës. Kjo e fundit ka kontrolluar çdo aspekt të veprimtarisë sime dhe familjarëve të mi në dekada pa qenë në gjendje të gjejnë asnjë shkelje.

36.10. Në dhjetor të vitit 2021, gjatë një interviste të dhënë në Tiranë, zëvendës ndihmës sekretari i Departamentit të Shtetit, Gabriel Escobar, u pyet nga gazetari: A do të thotë ndihma juaj për drejtësinë që ju edhe do të jepni prova dhe dosje dhe të dhëna për sistemin shqiptar të drejtësisë kur vjen fjala tek rasti i Z. Berisha dhe familjes së tij? Z. Eskobar u pergjigj se: Po, mund ta bëjmë⁸⁹. Por sot, pas gati dy vitesh, asnjë provë, fakt apo dokument nuk është sjellë dhe nuk është raportuar. Kjo sepse ato nuk ekzistojnë dhe përcaktimi im non grata ka në bazë korrupsionin transnacional.

36.11. Figura nga më të rëndësishmet të politikës në SHBA kanë shprehur shqetësimin e tyre për mungesën e provave që mbështesin vendimin e Sekretarit të Shtetit kundër meje dhe ndikimin korrptiv të George Soros në këtë vendim⁹⁰.

36.12. Në një intervistë televizive të kohëve fundit, Richard Grenell, ish-drejtori në detyrë i Inteligjencës Kombëtare të Shteteve të Bashkuara (DNI) deklaroi në mënyrë eksplicite se (i) gjatë kohës së tij si DNI në detyrë, pavarësisht se ishte shumë i përfshirë me Ballkanin, ai kurrë nuk pa ndonjë akuzë për korrupsion, dosje apo prova, kundër Sali Berishës edhe pse nëse do të kishte diçka të tillë ai do të duhej ta dinte, (ii) se veprimet e Sekretarit të Shtetit Blinken janë të nxitura nga partishmëria politike kundër një partie konservatore, dhe se (iii) është e papranueshme dhe e dyshimtë që pavarësisht kërkesave të përsëritura të kongresmenëve republikanë amerikanë drejtuar z. Blinken, për t'i informuar ata mbi provat mbi të cilat bazohet vendimi i tij kundër Berishës, ai ka refuzuar të paraqesë ndonjë provë, qoftë në seanca publike apo edhe seanca të mbyllura, pavarësisht se është ligjërisht i detyruar për të informuar anëtarët e Kongresit⁹¹.

⁸⁸ <https://abcnews.al/ke-ndikuar-ne-gjyq-yuri-ki-i-pergjigjet-berishes-shba-do-vazhdoje-betejen-kunder-korrupsionit/>

<https://lapsi.al/2023/07/01/ambasadorja-e-be-hohmann-ajo-ge-shkateroi-modelin-yuri-kim/>

⁸⁹ <https://al.usembassy.gov/sq/sq-teskt-i-intervistes-se-zv-ndihmes-sekretarit-te-shtetit-te-shba-gabriel-escobar-me-sokol-balla-real-story-news-24/>

⁹⁰ <https://lapsi.al/2021/06/08/non-grata-e-berishes-kongresmeni-leter-dash-kerkoj-nje-shpjegim-te-detajuar-mbi-procesin-e-ndjekur/>

<https://politiko.al/english/e-tjera/berisha-non-grata-kongresmeni-amerikan-i-shkruan-letren-e-trete-dash-it-i448425>

See also: Richard Grenell, speech in the Conservative Political Action Conference, July 2021, available at:

<https://www.facebook.com/watch/?v=2926070501045396>

Blinken Acts as Agent of George Soros in the Balkans | American Center for Law and Justice (aclj.org)

<https://euronews.al/shpallja-non-grata-e-berishes-philips-nuk-u-zbatuan-parimet-themelore-te-ligjit/>

⁹¹ <https://politiko.al/e-tjera/grenell-per-sanksionimin-e-berishes-skame-pare-dosje-ne-dash-blinken-i-p-i483586>

36.13. Skandali i fundit korruptiv i Charles McGonigal, ish-kreu i kundërzbulimit të FBI-së për NY, zbuloi se Rama kishte angazhuar me pagesë Charles McGonigal, gjatë kohës kur ai ishte në detyrë, si dhe ekipin e tij kundër opozitës dhe meje personalisht⁹². Gazetat amerikane dhe të vendeve të tjera⁹³ kanë shkruar se vendimi i Departamentit të Shtetit për dizenjimin e Berishës është bërë nën ndikimin e lobimit korruptiv të Ramës dhe se McGonigal dhe ekipi i tij (Marc Rossini dhe Lou Bladell) ishin të përfshirë drejtpërdrejt në çështjen Berisha⁹⁴. Shtoj se njëllonj si Mc Gonigal, por me mjete politike, u angazhua në luftën për shkatërrimin e opozitës edhe ambasadorja e SHBA Juri Kim, e cila për shkak të luftës së saj anti – opozitare jo rrallë e quanin sekretare të PS të Shqipërisë⁹⁵.

36.14. Shqetësimet mbi mënyrën jo-demokratike dhe jo-transparente të vendim-marrjes së Departamentit të Shtetit kundër Sali Berishës, rezonojnë me tone të forta në raportin e Këshillit të Ambasadorëve Amerikanë⁹⁶. Raporti mbi Ballkanin Perëndimor, i hartuar në vijim të misionit faktmbledhës të Këshillit të majit 2023, thekson (nënvizimi i shtuar) se⁹⁷:

“Kryeministri Rama dhe Partia Socialiste e Shqipërisë tashmë gëzojnë monopolin virtual të qeverisjes qendrore dhe asaj vendore. Partia Demokratike (PD), dikur në pushtet, bëri një seri llogarish të gabuara dhe e braktisi parlamentin në vitin 2017, duke u bashkuar në protesta në rrugë dhe më pas bojkotoi zgjedhjet lokale të 2019 për shkak të pretendimeve

⁹² <https://www.nytimes.com/2023/02/03/nyregion/fbi-intelligence-charged-albania.html>

<https://www.washingtonexaminer.com/opinion/the-albanian-shakedown-a-new-twist-in-the-fbis-charles-mcgonigal-scandal>

Former FBI agent Charles McGonigal’s side work puts bureau under new scrutiny - The Washington Post

<https://www.washingtonexaminer.com/opinion/the-fbi-balkan-scandal-keeps-spreading>

⁹³ [Hunter Biden’s link to disgraced ex-FBI official Charles McGonigal \(nypost.com\)](https://www.nypost.com/2023/02/03/hunter-biden-link-to-disgraced-ex-fbi-official-charles-mcgonigal/)

Gazetari gjerman, Herbert Bauernebel, korrespondent i gazetës Bild në New York, deklaroi në një intervistë për Syri TV ([here](#)), se rasti i Sali Berishës është interesant pasi sipas dokumenteve të Departamentit të Drejtësisë të SHBA-së dhe hetimeve të gazetarëve amerikanë, rezultoi se McGonigal është përfshirë në operacionin e caktimit non grata të ish-presidentit dhe kryeministrit Sali Berisha.

⁹⁴ Në lidhje me rolin e Rossini -t shih, [Ekskluzive në Top Story/ Mark Rossini kritika të forta: Berisha po bëhet kukull e Putinit - Top Channel \(top-channel.tv\)](#)

Në lidhje me Lou Bladel, sipas padisë së Uashingtonit të SHBA-së, më 4 mars 2018 McGonigal i prezantoi kryeministrit Rama paraardhësin e tij në FBI, ish-agjentin Lou Bladel. Në vijim të asaj mbledhjeje, qeveria shqiptare nënshkroi një kontratë të drejtpërdrejtë sekrete me EY, përfaqësuar nga Lou Bladel, më 28 maj 2018. Kryeministri Rama e prezantoi kontratën, me vlerë 375 mijë euro, duke deklaruar se kjo “nuk është një marrëveshje për shërbime konsulence, por një marrëveshje mbi aktivitete të përbashkëta në terren”. Më 8 tetor 2018, Sokol Balla, një gazetar shqiptar i njohur për lidhjet e tij shumë të forta me kryeministrin Rama, publikoi një tweet ([here](#)) duke iu referuar burimeve të brendshme, se “Bladel është në krye të një grupi hetimor që shqyrton korrupsionin dhe dosjet e akuzave ndaj opozitës {PD}”. Për rolin e ekipit të McGonigal-it shih: [Q&A Rama/McGonigal: the plot behind the effort to eradicate the DP \(campaign-archive.com\)](#).

[Lucas: Follow the \\$ through case of spies & State Dept. \(bostonherald.com\)](#)

⁹⁵ <https://www.syri.net/op-ed/603344/yuri-kim-po-iken-si-nje-hije-e-zeze-nga-shqiperia/> <https://www.syri.net/op-ed/603895/yuri-shqiptareve-u-ke-ngrene-buken-dhe-u-ke-permbysur-kupen/> <https://lapsi.al/2023/07/01/ambasadorja-e-be-hohmann-ajo-qe-shkateroi-modelin-yuri-kim/>

⁹⁶ Sipas faqes së tij të internetit, Këshilli i Ambasadorëve Amerikanë (the Council of American Ambassadors) është një organizatë jo-fitimprurëse dhe jo politike e ambasadorëve amerikanë jo- të karrierës të emëruar në gjashtë dekada nga 11 presidentë amerikanë, që organizon tavolina debatesh me ambasadorët në SHBA, organizon misione faktmbledhëse jashtë vendit, publikon një revistë gjashtë-mujore *American Ambassadors Review* dhe drejton programe edukuese në fushat e politikës së jashtme dhe interesit kombëtar.

⁹⁷ Nxjerrë nga raporti, i shkarkuar në 13 mars 2024, nga [Council of American Ambassadors](#)

për manipulime. Vizita jonë ishte pak përpara zgjedhjeve lokale në mbarë vendin, në një kohë kur PD po luftonte të rifitonte vendet e saj, ndërsa ishte shumë e dëmtuar nga ndarjet e brendshme, të cilat disa i konsiderojnë të stimuluar dhe financuar nga partia e Ramës. Në maj 2021, sekretari amerikan i shtetit, Antoni Blinken, duke vepruar sipas këshillës së Ambasadës së SHBA, e përcaktoi ish presidentin (1992-1997) dhe ish kryeministrin (2005-2013) Sali Berisha – i cili udhëhoqi qeverinë e parë post komuniste dhe e drejtoi vendin në rrugën e demokracisë – si të përjashtuar në mënyrë të përhershme nga përshtatshmëria për të hyrë në SHBA. Seksioni 7031(c) i ligjit të Departamentit të Shtetit, dhe Buxhetimit të Operacioneve të Huaja 2021, i dha sekretarit të shtetit Blinken dhe sekretarëve të ardhshëm, tagrin për të përcaktuar kështu një individ dhe familjen e tij/saj, në bazë të provave mbi kriminalitetin dhe korrupsionin të paraqitura dhe vlerësuar në seancë të mbyllur (in camera), pa mundësi kundërshtimi. Mbretëria e Bashkuar pasoi vendimin dhe Berisha pranoi në mes të vitit 2022 se ai nuk ishte më i përshtatshëm për të udhëtuar në Mbretërinë e Bashkuar. Mbi këtë bazë, Lulzim Basha, kryetari i Partisë Demokratike të Shqipërisë, e përjashtoi Berishën nga partia, duke shkaktuar një ndarje në partinë më të madhe opozitare përpara zgjedhjeve lokale.

Një sërë antarësh të delegacionit tonë e pyetën nga afër ambasadorin Kim dhe anëtarët e stafit të saj mbi vendimin për t'i ndaluar hyrjen Berishës në SHBA dhe kohën e këtij vendimi, duke kërkuar:

- të dhëna se çfarë provash mund të justifikonin një veprim të tillë përfundimtar dhe kaq gjithëpërfshirës kundër një politikani, dikur të afërt me SHBA;
- informacion nëse persona të tillë të akuzuar kishin pasur ndonjëherë mundësi të përdornin mekanizma për të kundërshtuar akuzat apo provat;
- nëse në këshillat për sekretarin Blinken ishin vlerësuar katërcipërisht shfaqja e ndërhyrjes elektorale dhe favoritizmi;
- precedentë në zbatimin e kësaj politike në raste të ngjashme.

Ambasadorja Kim dhe stafi i saj na siguruan se provat për të mbështetur këtë vendim ishin të shumta, por na komunikuan prerë se nuk mund të na tregonin ndonjë prej tyre. Ata gjithashtu pranuan se procesi ishte tërësisht i mbyllur (in camera), pa mundësi kundërshtimi dhe pa të drejtë apelimi. Kjo është jashtëzakonisht e rrallë, nëse jo unike, në jurisprudencën e SHBA. Simpatizantët e Berishës u ankuan se përcaktimi i tij ishte i ngjashëm me procedurat e Dhomës Star⁹⁸, në antitezë me traditën amerikane të procesit të rregullt. Githësesi, ambasadorja Kim na shpjegoi privatisht se lufta ndaj korrupsionit ishte e një rëndësie të atillë thelbësore për politikën e SHBA-së dhe e një prioriteti aq të lartë saqë zyrtarë të administratës Biden e kishin konsideruar të rëndësishme të bënin shembull dikë, për të theksuar se askush nuk është mbi ligjin apo imun kur bëhet fjalë për krime korrupsioni. Ne e dime se Berisha është 79 vjeç dhe, duke qenë pranë fundit të jetës së tij politike, mund të konsiderohet nga disa si një figurë e zëvendësueshme në politikë, por të sulmohet dike tjetër për ti dhënë mësim fajtorit të vërtetë nuk është mënyra amerikane e drejtësisë. Kjo ngjason më shumë me fjalën e urtë kineze “vrit pulat që të trembësh majmunët”. Berisha ka bërë padi në Francë kundër sekretarit amerikan të shtetit dhe

⁹⁸ Star Chamber, gjykatë e shekujve 15-17, e krijuar për të gjykuar aristokracinë e fuqishme dhe shpesh anti-monarkike, e cila gjykonte në seanca të mbajtura në fshehtësi dhe me mjete që përfshinin torturën. Termi procedurë e Dhomës Star, përdoret sot si sinonim i një procesi gjyqësor arbitrar dhe të padrejtë. https://www.law.cornell.edu/wex/star_chamber_proceedings#:~:text=Star%20chamber%20proceeding%20is%20a,arbitrary%20and%20unfair%20adjudicatory%20proceeding.

përfaqsohet falas në Washington nga një lobist i shquar.”.

37. Home Office thekson, në dokumentet e dorëzuara, se vendimi i tyre nuk është koordinuar dhe nuk synon të mbështesë Edi Ramën. Por faktet flasin ndryshe.

37.1. Dy vite para se të shpallesha non grata nga Departamenti Amerikan i Shtetit, Edi Rama ishte i pari që e publikoi këtë fakt në parlament⁹⁹. Gjithashtu, Edi Rama ishte i pari që deklaroi në parlament se do të shpallesha non grata nga Britania e Madhe, përpara se unë të merrja njoftim nga ndonjë burim tjetër, përfshirë edhe kanalet zyrtare¹⁰⁰.

37.2. Pasi unë iniciova lëvizjen e Rithemelimit të Partisë Demokratike, ambasadori britanik filloi fushatë kundër meje, duke u përpjekur të bindte bashkëpuntorët e mi që të mos mbështesnin iniciativën time për rithemelimin dhe të mos mbështesnin kandidaturën time për kryetar.

38. Me të drejtë dikush mund të pyesë: si është e mundur që Home Office të bazojë akuzat dhe vendimet e tyre në gënjeshtër, shpifje dhe trillime absurde?

39. E vërteta është se këto akuza janë dëshmi e qartë e lidhjeve korruptive të ambasadorit britanik King – Smith dhe paraardhësit të tij Norman Duncan, në Tiranë, të cilët nën ndikimet korruptive të Edi Ramës dhe qeverisë së tij, i kanë transmetuar si të vërteta tek autoritetet e vendit të tyre gënjeshtër e mediave të kontrolluara nga Soros dhe deklaratat e kundërshtarëve të mi politikë. Bazuar në këto falsifikime dhe trillime, këta diplomatë të korruptuar njësoj si Charles McGonigal, janë angazhuar në shkatërrimin e opozitës shqiptare dhe forcimin e pushtetit autokrat të Edi Ramës.

40. Shembuj të dizinformatave të ambasadorit King – Smith ofrohen në mënyrë të qartë e të përsëritur nga dokumentet e paraqitura nga Home Office në këtë proces. Nga seria e trillimeve që i ka dërguar qeverisë së tij, citoj fabrikimin e zotit King – Smith se pas urdhrit të përjashtimit, Sali Berisha ka nisur sulme publike kundër qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar¹⁰¹. Është lehtësisht e verifikueshme që kjo deklaratë është një gënjeshtër e pastër. Nuk ka asnjë deklaratë publike apo komunikim publik të çfarëdo lloji, në të cilin unë sulmoj qeverinë e Mbretërisë së Bashkuar, për çfarëdo arsye. Përkundrazi, unë kam denoncuar në deklaratat e mia publike në Kuvend dhe intervistat e mia në mediat shqiptare¹⁰² dhe ato të MB¹⁰³, sulmet e Edi Ramës dhe ministrave kundër qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar, për çështjen e emigrimit të paligjshëm të shqiptarëve, si dhe eksportimin e kriminalitetit nga Shqipëria në MB dhe vendet e tjera. Shtoj këtu, se si ish president dhe ish kryeministër i këtij vendi, pas rënies së diktaturës komuniste, kam punuar me përkushtim të veçantë për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike dhe të gjithanshme dhe zgjidhjen me sukses të plotë të të gjitha problemeve midis dy vendeve, të mbartura nga diktatura

⁹⁹ <https://www.oranews.tv/article/kryeministri-sfidon-berishen-e-kalon-dot-oqeanin>

¹⁰⁰ <https://gazetasi.al/non-grata-edhe-nga-britania-rama-paralajmeron-serish-berishen/>

¹⁰¹ Annex G§2: “However, in response disputed Democratic Party leader Sali Berisha has launched public attacks against both HMG and HMA Tirana personally”.

¹⁰² <https://politiko.al/ditari-i-opozites/pd-demon-gjuhen-e-rames-berisha-britanise-analizoni-pse-shqipt-i470104>

¹⁰³ <https://www.dailymail.co.uk/news/article-11421577/Albanians-streets-demonstrate-against-government-rising-cost-fuel-food.html>

<https://www.dailymail.co.uk/news/article-11421577/Albanians-streets-demonstrate-against-government-rising-cost-fuel-food.html>

komuniste. Në vizita zyrtare në Britaninë e Madhe, jam pritur në Buckingham Palace, 10 Downing Street dhe Parlamentin Britanik. Kam pasur nderin të pres anëtarë të familjes mbretërore, anëtarë të nderuar të parlamentit e qeverisë britanike. Partia Demokratike, që nga themelimi i saj, ka patur një bashkëpunim të ngushtë dhe të çmuar me Partinë Konservatore të BM. Gjatë viteve të mia në pushtet, Britania e Madhe ka dhënë një mbështetje të çmuar për reformat transformuese të vendit, anëtarësimin e tij në KiE, NATO dhe progreseve thelbësore drejt integritimit në BE.

41. Në dokumentin e sipërcituar¹⁰⁴, i vetëdijshëm se shpifjet dhe trillimet që i ka dërguar qeverisë së tij ndaj meje nuk qëndrojnë dhe nuk i mbron dot në gjyq, ambasadori shkruan se “Nëse kundërshtimi gjyqësor i Berishës për përjashtimin e tij është i suksesshëm. Qeveria britanike do të përballet me dëmtimin e reputacionit të saj ndërkombëtar, veçanërisht në Ballkanin Perëndimor”¹⁰⁵. Madje në llogjikën e keqbërësit po aty shton se: “...edhe heqja e urdhrin të përjashtimit të Berishës para gjykimit do të sjellë një dëmtim të njëjtë dhe ka të ngjarë edhe më të madh të reputacionit”¹⁰⁶.

42. Keto rekomandime të Ambasadorit King Smith në Tiranë janë një përpjekje e dëshpëruar për të mbrojtur veten nga keqbërjet e tij dhe për të mbuluar disinformimin që i ka bërë qeverisë së tij. Ai përdor si argument kryesor për mbajtjen e sanksioneve, jo të vërtetën e mbështetur në prova, por dëmtimin që pretendohet se i vjen reputacionit të MB, nëse vendimi i padrejtë për sanksionimin tim do të anulohet nga drejtësia britanike, falë mungesës totale të provave. Sipas këtij arsyetimi, reputacionin e dëmton jo mbajtja e një vendimi të pabazuar në prova, por korrigjimi i një vendimi të padrejtë e të pabazuar.

43. Në rekomandimet e tij ambasadori King Smith tregon se ai, për të mbrojtur karrigen e tij dhe denigruar me trillime një njeri tjetër të pafajshëm, është i gatshëm të injorojë drejtësinë, ligjin, ndershmërinë, të cilat janë elemente thelbësore të reputacionit të vendit të tij.

44. Në rekomandimet e tij për mos-heqjen e vendimit të pabazuar të Home Office, në mungesë të provave, ambasadori King – Smith përdor kundër meje argumente të mirëfillta politike. Duke dëshmuar anshmëri të theksuar politike ai shpreh shqetësimin se heqja e vendimit të Home Office kundër meje do të ndikojë pozitivisht në rezultatin e Partisë Demokratike në zgjedhjet lokale: “...Ky rrisht është më i madh për shkak të periudhës së zgjedhjeve lokale të Majit 2023, në të cilat Berisha përballet me një sfidë të forte për të ruajtur votat dhe vëndet e partisë së tij”¹⁰⁷.

45. Përveç këtyre, ai përdor një tjetër argument politik absurd për mos heqjen e urdhrin të përjashtimit tim. Ai i shkruan qeverisë se tij se: “Heqja e përjashtimit për Berishën mund të paraqesë rrezik reputacional për Home Office dhe më gjerë për Qeverinë e Madhërisë së Tij

¹⁰⁴ Annex G.

¹⁰⁵ Annex G§4: “If Berisha’s legal challenge to his exclusion is successful HMG will face international reputational damage, particularly in the Western Balkans region”.

¹⁰⁶ Annex G§5: “Withdrawing Berisha’s exclusion ahead of his legal challenge would lead to at least as significant – and likely greater – reputational damage”.

¹⁰⁷ Annex G, §4 “... This risk is heightened by the timeline for local elections which take place in May 2023, where Berisha faces a tough challenge to retain his party’s share of the vote and seats”.

(QMT). Britania e madhe ka marrë keto kohë kritika publike nga liderë të rëndësishëm shqiptarë (përfshirë kryeministrin Edi Rama) për paraqitjen në media të emigrantëve shqiptarë”¹⁰⁸. Është e vertetë se Edi Rama gjatë krizës së refugjatëve sulmoi qeverinë konservatore mbi baza politike si raciste. Por është krejtësisht absurde ideja se keto sulme, të cilat nuk kanë asnjë lidhje me mua, mund të perdoren si argument kundër heqjes së urdhrat të pabazuar të Home Office ndaj meje, pasi do të dëmtonin reputacionin e QMT.

46. Në përpjekje për të mbrojtur trillimet që i ka dhënë qeverisë së tij kundër Berishës, ambasadori King Smith, paraqet Carlo Bollino, si dëshmitar të paanshëm. Ai vlerëson besueshmërisë e mediave të Bollinos, shqiptarja.com dhe Report. tv, si media që "... anojnë pak nga qeveria, por jo dhe aq shumë"¹⁰⁹. Ky përshkrim është një tallje me realitetin dhe shqiptarët që jetojnë në këtë vend. Carlo Bollino njihet në Shqipëri, jo vetëm për mbështetjen e verbër për Ramën dhe qeverinë e tij, por para së gjithash, për akuzat se Rama i shpërblen shërbimet e tij me kontrata koncesionesh fitimprurëse, asete publike dhe sipërmarrjet e tjera korruptive¹¹⁰. Këto fakte janë publikuar gjerësisht në mediat shqiptare, por ambasadori ka zgjedhur t'i fshehtë ato dhe të paraqesë tek Home Office një rrëfim tërësisht të deformuar.

47. Janë disa burime shqiptare që informojnë se, pasi gënjeu qeverinë e tij për kinse lidhjet e mia me grupet kriminale dhe korrupsionin, ambasadori britanik tani troket në dyert e ministrive dhe institucioneve qeveritare shqiptare duke kërkuar dokumente apo fakte për korrupsionin e Berishës, duke thënë se "...n'a duhen fakte pasi rrezikojmë të humbim çështjen në gjykatë".

48. Opinioni publik dhe media në Shqipëri kanë vënë në dukje se ambasadori King - Smith, në të njëjtën linjë veprimi me qeverinë e Edi Ramës, është kthyer në një armë kundër opozitës shqiptare dhe duke e bërë këtë, dëmton mekanizmat e kontrollit dhe balancës që ofron një opozitë e vërtetë në çdo shoqëri demokratike¹¹¹. Në kontrast të thellë nga përjasja e tij me opozitën shpaloset qëndrimi i z. King Smith ndaj qeverisë, të cilën mediat e kanë vënë vazhdimisht në dukje si një sjellje të pazakontë¹¹².

49. Si konkluzion, akuzat e ngritura nga Home Office mbi çështje të 25-15 viteve më parë, si dhe

¹⁰⁸ Annex G§7.

¹⁰⁹ Annex F, §11.

¹¹⁰ <https://www.state.gov/reports/2022-country-reports-on-human-rights-practices/albania/>
<https://pd.al/2020/09/endri-hasa-skema-e-korrupsionit-si-transferohen-parate-e-tenderave-te-fituar-nga-igligjelishti-ne-llogarite-e-carlo-bolinos/>
<https://dosja.al/denoncimi-i-pd-hasa-rama-i-dha-1-miliarde-lek-carlo-bolinos-permes-kompanise-se-igligjelishtit-parate-e-tenderave-shkon-per-makiazh-te-propagandes-qeveritare-deklarata> <https://www.cna.al/denoncim/skema-korruptive-e-carlo-bollino-s-qe-nuk-u-cua-ne-spak-i354641> <https://www.cna.al/aktualitet/carlo-bollino-si-misionar-i-mediave-apo-lepires-i-pushtetit-i348866> <https://www.cna.al/aktualitet/carlo-bolino-si-fjale-e-lire-si-ka-perfituar-nga-parate-e-shqiptareve-i349066> <https://www.cna.al/2022/01/05/milionat-e-inceneratorave-pushtojne-mediat-kikia-mbeshtet-denoncimin-e-cna-al/>

¹¹¹ <https://www.syri.net/politike/577614/mediat-britanike-groposin-ramen-ambasadori-do-te-gropose-opoziten/>
<https://boldnews.al/2022/10/14/diplomacia-e-erret-si-punoi-ambasadori-britanik-kunder-opozites-faktet/>

¹¹² <https://dosja.al/politike/king-smith-alastair-king-smith-si-depertoi-mes-socialisteve-ambasadori-i249565>
<https://www.podiumi.com/2021/10/11/vetem-ne-shqiperi-behen-ambasadoret-e-huaj-guvernator-e-vip-a-se-ne-britani-dhe-kudo-ne-perendim-nuk-i-njeh-as-komshiu/>

të gjitha dokumentat e paraqitura nga Home Office, si provë për të mbeshtetur perjashtimin tim, janë kryekëput të bazuara në shpifje, interpretime të pavërteta të artikujve të mediave të kontrolluara nga George Soros dhe akuza të pabaza të kundërshtarëve të mi politik. Ato në asnjë moment nuk provojnë asnjë lidhje me krimin e korrupsionit, si dhe asnjë lloj shkelje ligjore apo përfitim të paligjshëm nga unë, familjarët e mi, PD apo personat e tjerë që përmenden në to.

50. Ndaj, përjashtim im është një rast klasik i përdorimit të korrupsionit transnacional si armë nga qeveria e Edi Ramës, për të sanksionuar kundërshtarët politikë, për të shkatërruar opozitën dhe për të mbrojtur kësisoj, korrupsionin dhe lidhjet e tij dhe qeverisë së tij me krimin.

51. Sanksionimi im ka patur si qëllim madhor së pari, të zhvlerësojë dhe të bëjë të pabesueshëm një zë që ka denoncuar dhe denoncon, me shumë se kushdo tjetër, me dhjetra e qindra afera korruptive të qeverisë më të korruptuar në Europë, përfshi këtu aferat e mëdha si ajo e djegësave, apo e Portit të Durrësit, të cilat janë denoncuar së fundmi edhe nga Parlamentit European dhe Departamenti i Shtetit.

52. Së dyti, sanksionimi është një mjet që kërkon të zhvlerësojë zërin që ka denoncuar, përsëri më shumë se kushdo tjetër, lidhjet e Edi Ramës dhe qeveritarëve të tjerë me krimin dhe kartelet e drogës në Shqipëri, Sinaloan e Meksikes dhe vendet e tjera në botë. Prandaj, vendimi i pabazë i Home Office paraqet një rast tipik të përdorimit të sanksioneve, jo për të dekurajuar krimin e organizuar dhe korrupsionin, por për hakmarrje tipike politike.

53. Së treti, ambasadori King Smith dhe parardhësi i tij Norman Duncan, njelloj si McGonigal, u përdorën nga qeveria si armë për shkatërrimin e opozitës dhe konsolidimin e regjimit monist të Edi Rames në Shqipëri. Mirëpo, shkatërrimi i opozitës është vrasja e shpresës dhe shkatërrimi i një shoqërie të lirë. Sot rregjimi i Edi Ramës, me politikën e tij, ka shndërruar shqiptarët edhe në vitin 2023 në *boat people* dhe sipas Eurostat, gjatë viteve 2014-2021, ka larguar 937000 qytetarë nga Shqipëria drejt hapsirës Shengen.

